

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

Progres Raporti 2008 për Shqipërinë

1. HYRJE

1.1 Parathënie

Që në mars 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky progres raport ndjek thujtë të njëjtën strukturë si vitet e kaluara. Raporti:

- përshkruan shkurtimisht marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kriterit politik për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kriterit ekonomik për anëtarësim;
- shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për zbatimin e standardeve evropiane, domethënë, përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis*, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian.

Ky raport mbulon periudhën nga 1 tetori 2007 deri në fillim të tetorit 2008. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo qasje garanton trajtim të barabartë midis raporteve dhe vlerësimit objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuara nga Komisioni. Përveç këtyre, janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, e Shteteve Anëtare, raporteve¹ të Parlamentit Evropian, dhe informacionet nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe jo-qeveritare.

Komisioni nxjerr përfundime të hollësishme për Shqipërinë në komunikatën e tij të veçantë për zgjerimin², bazuar në analizën teknike që përmban ky raport.

1.2 Konteksti

Shqipëria është kandidate potenciale për anëtarësim në BE.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së u nënshkrua në qershor 2006. Marrëveshja e Përkohshme është në fuqi që në dhjetor 2006.

1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

¹ Për Shqipërinë, raportues është z. Libor Rouček.

² Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2008-2009.

Shqipëria aktualisht merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit**.

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në në qershor 2006. MSA shtron një kuadër angazhimesh të ndërsjella për një rang të gjerë çështjesh politike, tregtare dhe ekonomike. Çështjet e MSA-së që lidhen me tregtinë po vihen në zbatim nëpërmjet Marrëveshjes së Përkohshme derisa të përfundojë ratifikimi i plotë i MSA-së. Marrëveshja e Përkohshme hyri në fuqi në dhjetor 2006. Dispozitat e bashkëpunimit të Marrëveshjes për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar (TCECA) vazhdojnë të kenë efekt deri në ratifikimin e MSA-së. Shqipëria gjithashtu përfiton nga masat autonome tregtare të dhëna nga BE.

BE udhëzon autoritetet shqiptare mbi prioritetet e reformave nëpërmjet **Partneritetit Evropian**. Progresi në këto reforma kryesore inkurajohet dhe monitorohet përmes dialogut politik dhe ekonomik me Shqipërinë. Dialogu zhvillohet nëpërmjet Trojkës Ministrore, takimeve të komiteteve të përbashkëta dhe grupeve konsultative (CTF) në nivel ministror dhe takimet e grupit të punës në nivel zv/ministrash.

Takimi i Trojkës Ministrore me Shqipërinë në qershor 2008 u fokusua në prioritetet kyçe politike, përfshi çështjet rajonale. Komiteti i përbashkët u takua në dhjetor 2007 për të vëzhguar funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Përkohshme dhe TCECA-s. Dy takime CTF (Grupi i Përbashkët Konsultativ) dhe gjashtë takime të grupit të punës u zhvilluan nga periudha tetor 2007 deri në fillim të tetorit 2008. Takimet CTF u fokusuan në kriterin politik të anëtarësimit dhe çështjet e shtetit të së drejtës. Secili takim CTF u mbyll me disa rekomandime të përbashkëta për ndërhyrje nga ana e autoriteteve shqiptare. Takimet e grupit të punës u fokusuan në çështje ekonomike, sektoriale dhe të tregut të brendshëm, dhe i raportuan komitetit të përbashkët.

Në korrik 2008, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje për të kontribuar me 62 ushtarë në operacionet ushtarake të misionit të Bashkimit Evropian në Çad dhe Afrikë Qendrore (EUFOR).

Pas hyrjes në fuqi të **marrëveshjes mes KE dhe Shqipërisë për lehtësimin e vizave** në janar 2008, takimi i parë i komitetit të përbashkët u realizua në prill 2008. Marrëveshja e lehtësimit të vizave thjeshton procedurat për dhënien e vizës për disa kategori të caktuara qytetarësh të Shqipërisë ku përfshihen studentët, akademikët, biznesmenët, gazetarët dhe turistët. Sipas termave të marrëveshjes, qytetarët shqiptarë ose paguajnë tarifë të reduktuar për vizën, ose e marrin atë falas. Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit KE-Shqipëri e cila hyri në fuqi në 2006, po ecën mirë. Kjo marrëveshje përcakton detyrime dhe procedura të qarta për autoritetet si të Shqipërisë dhe të Shteteve Anëtare të BE-së në lidhje me kur dhe si të pranohen njerëzit të cilet janë ilegalisht rezidentë në territoret e tyre.

Që në vitin 2007, asistenca financiare e para-aderimit në Shqipëri sigurohet mes Instrumentit të Ndhmës së Para-aderimit (IPA). KE angazhoi një total prej 70.7 milion Eurosh në 2008. Dokumenti Indikativ Shumëvjeçar i Planifikimit (MIPD) për 2008 -2010 për Shqipërinë nën instrumentin IPA u miratua në Shtator 2008. Fushat më të rëndësishme vazhdojnë të jenë drejtësia dhe çështjet e brendshme, ngritja e kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik dhe social dhe stabilizimi demokratik. Asistenca e ofruar nga CARDS dhe IPA po implementohet nga Delegacioni i KE në Tiranë. Manaxhimi i ndihmës në mënyrë të decentralizuar është një objektivi afat-mesëm për Shqipërinë. Marrëveshja Kuadër IPA u nënshkrua në 18 Tetor 2007. Marrëveshja e Financimit për Programin Kombëtar 2007 nën Komponentin e Ndhmës Tranzitore dhe Ngritjes së Institucioneve u nënshkrua në 22 Janar 2008 dhe zbatimi i programit ka filluar. Marrëveshjet e Financimit për programet e bashkëpunimit ndër-kufitar u nënshkruan në Prill 2008.

Përsa i përket mbështetjes për shoqërinë civile, janë parshikuar 4 milione euro për forcimin e rolit të shoqërisë civile dhe mediave në procesin e integritimit Europian për periudhën 2008-2010. Shqipëria ka marrë mbështetje nga vendet antare të BE mes Qendrës për Monitorim dhe Informim të Mbrojtjes Civile së BE (MIC) për të ndihmuar me pasojat e shpërthimit të Gërdecit në Mars 2008.

Përsa i përket Programeve Komunitare, Shqipëria merr pjesë në Programin e 7-të Kuadër të Kërkimit për të cilin është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në Dhjetor 2007. Vendi gjithashtu është pjesëmarrës në Programin Kuadër për Sipërmarrje dhe Inovacion, me nënshkrimin e një memorandumimi mirëkuptimi në Qershor 2008.

2. KRITERI POLITIK

Ky seksion analizon progresin e bërë nga Shqipëria drejt plotesimit të kriterit politik të Kopenhagenit, që kërkon stabilitet të institucioneve duke garantuar demokracinë, respektimin e ligjit, të drejtave të njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira të fqinjësisë me vendet e zgjerimit dhe Vendet Anetare, dhe respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

Kushtetuta

Në Prill 2008, parlamenti miratoi një paketë ndryshimet kushtetuese bazuar në konsensus mes dy partive më të mëdha, mbi sistemin zgjedhor, zgjedhjen e Presidentit dhe mandatimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Si pjesë e ndryshimeve kushtetuese, sistemi zgjedhor shqiptar, ndryshoi nga një sistem miks në një sistem rajonal proporcional (140 vende përfaqësimi proporcionale plotësuar nga listat partiake në rajonet që i korrespondojnë ndarjeve ekzistuese administrative). Partitë më të vogla, duke përfshirë këtu ato që përfaqësojnë minoritetet kombëtare, kundërshtuan këtë ndryshim, duke pretenduar që kjo mund ti përjashtojë efektivisht ato nga Parlamenti. Ato gjithashtu u ankuan që ndryshimet në mënyrën e zgjedhjes së Presidentit dhe të mandatimit të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk ishin diskutuar majftueshëm.

Parlamenti

Parlamenti ka konsoliduar më tej rolin e tij si fokus për debatin politik. Një numër i konsiderueshëm ligjesh ka kaluar me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me *Acquis* të BE-së.

Forcat politike kane filluar bashkëpunimin në ceshtje madhore. Ky konsensus mes maxhorances ligjore dhe partise me të madhe opozitare ka rezultuar në arritjen e progresit në reformat e gjyqësorit dhe ato zgjedhore. Sidoqoftë, duhet bere akoma me shume per te nxitur dialogun konstruktiv ndermjet partive politike dhe me grupimet e interesit , të cilat janë prioritete kyc të Partneritetit Evropian.

Në Korrik 2008, Parlamenti ngriti një komision ad-hoc për hartimin e Kodit Zgjedhor. Përfundimi i reformës zgjedhore do të kërkojë miratimin në kohë të një Kodi Zgjedhor gjithëpërfshirës dhe transparent që të lejojë zgjedhje të lira dhe të ndershme në 2009, një prioritet kyc i Partneritetit Evropian.

Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian kontribuoi në rritjen e ndërgjegjesimit mbi procesin e Integritimit Evropian. Sidoqoftë, nuk është bërë progres në rritjen e rolit të Parlamentit në monitorimin e zbatimit të detyrimeve të MSA. Niveli i ulët i ekspertizës në Parlament nuk siguron një vlerë të shtuar në cilësinë e akteve ligjore dhe harmonizimin me *Acquis* të BE.

Marredhëniet mes Parlamentit dhe Presidentit u veshtiresuan ne disa raste. Parlamenti rrezoi emërimet e gjyqtareve nga presidenti per ne Gjykatën e Lartë në Qershor dhe eventualisht aprovoi emerime te reja ne Korrik. Ky proces ngriti shqetësime mbi pavaresinë e institucioneve të shtetit nga ekzekutivi.

Parapergatitjet per regjistrin civil elektronik dhe sistemin e adresave përfunduan në Shtator 2008 duke siguruar bazën për kartat e identitetit, listën e votuesve dhe pasaportave biometrike. Zyrat e regjistrimit civil kanë filluar lëshimin e certifikatave të printuara. Një sistem i shëndoshë i regjistrit civil dhe sistemit të adresave është guri i themelit për lista te votuesve dhe dokumenta te besueshem. Burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore duhet ende të investohen për të siguruar koordinim dhe qëndrueshmëri të këtij prioriteti kyc të Partneritetit Evropian. Përgatitjet për listat e votuesve para zgjedhjeve duhet të bëhen me eficientë dhe transparencë.

Si përfundim, nje dialog më konstruktiv mes partive më të mëdha politike ka mundësuar progresi në adresimin e prioriteteve kyc të Partneritetit Evropian. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor mbeten për tu miratuar para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Qeveria

Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ka perforcuar rolin e saj në koordinimin e integritimit evropian. Sidoqofte, roli i MIE si koordinator qendror për procesin e integritimit Evropian duhet të konsolidohet më tej. Jo të gjitha draftet ligjore janë kontrolluar në mënyrë sistematike për përputhshmërinë e tyre me MSA dhe *acquis*. Për më tepër, funksionet e njësive të integritimit Evropian në 13 ministritë e linjës nuk janë standardizuar dhe disa prej ketyre njesive mbeten me staf te pamjeftueshem. Nevojiten programe trajnimi të specializuara per administratën publike mbi ceshtjet e BE. Komisioni Ndërmintor mbi Integrimin Evropian që kryesohet nga Kryeministri është mbledhur vetem dy herë.

Situata e plotësimit me staf në MIE është përmiresuar. Numri total i stafit u rrit nga 67 në 77 ne 2008. Pozicionet drejtuese janë plotësuar dhe është rekrutuar staf plotesues.

Në Mars 2008, u miratuan nga Qeveria udhëzimet për koordinimin ndër-institucional për integrimin evropian. Në Qershor, MEI përgatiti raportet e vleresimit të mangesive për përafrimin me *acquis* në sektoret më të rëndësishëm. Këto përdoren për të përditësuar Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-se. Jane shuar perpjekjet për të permiresuar koordinimin me Departamentin e Bashkerendimit të Strategjive dhe dhe Kordinimit te Ndhimes se huaj (DSDC), i cili eshte pergjegjes per të gjithë asistencen e huaj.

Strategjia Kombetare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) u miratua në Mars 2008, pas konsultimesh të limituara me shoqërinë civile. Ajo parashikon 35 strategji sektoriale, nga të cilat 17 janë miratuar tashmë. Strategjitë sektoriale janë një pjesë e rëndësishme e Sistemit të Integruar të Planifikimit të qeverisë, për përfaqshjen e politikave të qeverisë me procesin e buxhetimit nën Programin Afat-mesëm Buxhetor.

Megjithatë, parashikimet e kostove dhe indikatorët e performancës për secilën nga strategjitë sektoriale nën SKZHI mbeten jo të mjaftueshme dhe të njëtrajtshme.

Qeveria miratoi strategjinë e parë të saj për zhvillimin rajonal në Nëntor 2007 si një pjesë e reformës afatgjatë të saj për decentralizimin. Gjatë 2008, MEI forcoi koordinimin mbi zhvillimin rajonal me një sërë ministri te linjes, me qëllim përgatitjen për Fondet Strukturore.

Per sa i perket hartimit te politikave vepruese, koordinimi me shoqerinë civile mbetet i dobet. Konsultimet ndërministrrore mbi draftet ligjore funksionojnë dobët në praktikë. Kërkesat ekzistuese për konsultime publike mbi politikat e BE, nën rregullat e funksionimit të Qeverisë, nuk aplikohen plotësisht. Dobësitë në zbatimin e legjislacionit dhe të vendimeve të gjyqësorit duhet të adresohen. Rregullimet e tanishme për koordinimin e çështjeve evropiane, vecanërisht në MEI, duhet të përforcohen.

Ne pergjithesi Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres në perforcimin e strukturave të saj qeveritare me qëllim adresimin e angazhimeve të MSA, një prioritet kyc i Partneritetit Evropian. Sidoqoftë, mbetet i nevojshme forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve, koordinimit dhe planifikimit strategjik për integrimin evropian.

Administrata publike

Në Dhjetor 2007, qeveria miratoi ndryshimet në Ligjin “Mbi vlerësimin e performancës së nënpunesit civil”. Në Janar 2008, një sistem i ri gradash për nënpunesit civil ka hyrë në fuqi. Sidoqoftë, qarkullimi i stafit si pasojë e presioneve politike vazhdon. Ligji “Për shërbimin Civil” është në fuqi por nuk aplikohet sistematikisht.

Departamenti i Administrates Publike (DAP) po harton një strategji mbi reformën në administratën publike, e cila perfshin plane per trajnime sektoriale dhe qe mbulojne dhe strukturat e qeverise lokale. Megjithatë, roli i DAP në sigurimin e zbatimit të ligjit mbi Shërbimin Civil dhe kapaciteti i Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) mbeten të dobëta. Kapaciteti i Departamentit të Administratës Publike në orientimin e shërbimit civil drejt një strukture profesionale dhe te bazuar ne merite duhet të forcohet më tej.

Mungesa e mekanizmave të shëndoshë të përgjegjshmerisë në administratën publike rrit rastet per anashkalimin e procedurave të vendosura. Emërimet kanë kaluar nëpër linjat e partive politike në kundërshtim me Ligjin e Shërbimit Civil. Autoriteti DAP-it , me qëllim zbatimin e vazhdueshëm të emërimeve zyrtare, klasifikimit të pozicioneve të punës dhe kriterit të promovimit. Zbatimi i plotë i Ligjit të Shërbimit Civil dhe miratimi i strategjisë për administratën publike janë celësi i suksesit lidhur me këtë çështje.

Pagat në sektorin publik u rriten në Korrik 2008. Qeveria vazhdon të inkurajojë të diplomuarit shqiptarë në universitetet e huaja, të hyjne në shërbimin civil. Plani i trajnimit për shërbimin civil është rishikuar me qëllim reflektimin më të mirë të nevojave. Megjithatë, zëvendesimet e shpeshta të nënpunesve civil po dëmtojnë pavaresinë e shërbimit civil dhe po rrisin rastet e korrupsionit të zyrtarëve publikë.

Si përfundim, administrata publike po vazhdon të stabilizohet, por mungesa e transparencës dhe përgjegjshmërisë në emërimet po rrezikon pavaresinë e saj. Cfarë është e nevojshme tashmë, është forcimi i mëtejshëm i qeverisjes së sektorit publik, duke rritur pavaresinë e administratës publike, një prioritet kyc i Partneritetit Evropian. Progres i metejshëm duhet bërë për krijimin e një shërbimi civil të pavarur, bazuar mbi meritën dhe profesionalizmin.

Sistemi gjyqësor

Procedurat e gjyqësorit kanë mbetur të ngadalëta dhe kanë mungesë transparence.

Në muajin Mars 2008, një Pakt Kombëtar ndër-partiak në fushën e drejtësisë u mbështet nga partitë kryesore politike. Gjithësesi, një strategji për reforme dhe vizion për gjyqësorin, përtej miratimit të pjesëve individuale të legjislacionit, ende mungon. Ajo ç'ka nevojitet tani është miratimi i një strategjie e hollesishme për reformën e gjyqësorit, për të plotësuar kuadrin ligjor dhe siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e tij.

Një fare progresi mund të raportohet me miratimin në të Ligjit mbi Organizimin e gjyqësorit miratuar në shkurt 2008 i cili përcakton kategoritë e pagave dhe kriteret mbi baza merite për emërimet në gjyqësor. Rekrutimi i gjyqtarëve bëhet vetëm midis të diplomuarve të shkolles së magjistraturës. Gjithësesi, ligji nuk qartëson kompetencat e ndara të inspektoratëve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo ngre shqetësime serioze rreth pavaresisë së gjyqësorit.

Një ligj është përgatitur mbi privatizimin e sistemit të përmbartimit për zbatimin të vendimeve të gjykatave civile. Gjithësesi, zbatimi i vendimeve nga përmbartimi mbetet i ngadalë. Një sistem i kompjuterizuar për menaxhimin e çështjeve civile është instaluar tashmë në të gjitha gjykatat, dhe është zgjeruar me tej për të mbuluar dhe çështjet penale. Sistemi i regjistrimit rastet në mënyrë elektronike dhe ia cakton gjyqtarëve në mënyrë të rastësishme. Gjithësesi, trajnim i mëtejshëm në lidhje me përdorimin e tij nevojitet. Sistemi i gjykatave vazhdon të jetë problematik, me procedura ende të ngadalta dhe jo-transparente.

Ndërtesa e gjykatës së krimeve të rënda në Tiranë është afër përfundimit. Gjykatat kanë mungesë hapësirash adekuate për arkivat dhe pajisjet për transkriptimet, që bëhen kryesisht me shkrim dore. Për shkak të mbipopullimit, shume gjykata nuk mund të lejojnë aksesin e publikut në seanca. Kjo pengon transparencën dhe eficiencën e gjykatave. Buxheti i shtetit i alokuar për gjyqësorin mbetet i pamjaftueshëm për funksionimin normal të pjesës më të madhe të gjykatave.

Në përgjithësi, infrastruktura e gjyqësorit kërkon një forcim të konsiderueshëm. Shkolla e magjistraturës mbetet një institucion i rëndësishëm për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë edhe çështjet që janë të përfshira në MSA. Mbështetje adekuate për shkollën nga buxheti i shtetit nevojitet për të siguruar qëndrueshmëri. Trajnim i mëtejshëm më i specializuar për gjykatësit nevojitet.

Vendimet e gjykatës kushtetuese janë nxjerre mbi rolin e komisioneve hetimore parlamentare, duke përfshirë rastin e heqjes së ish Prokurorit të Përgjithshëm Sollaku, rolin e ekzekutivit në marrëdhënie me organet e pavarura të shtetit dhe mbi standardet për nxjerrjen e dekreteve të qeverisë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka ndermarre një sërë iniciativash, duke përfshirë seancat degjimore për publikun për kryetaret e rinj të gjykatave. Ka pasur disa përmirësime të kufizuara në funksionimin e brendshëm të KLD. Sistemi i ri për vlerësimin profesional të gjyqtarëve nga KLD

po ecen gadale. Situata e gjyqtarve të prekur nga shfuqizimi i tete gjykatave të vogla në rethe në shtator 2007 mbetet e pazgjidhur.

Ne Prill 2008, nje marreveshje bashkëpunimi u nenshkrua ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe policisë së shtetit, ku perfshihen masa për përmirësimin kryerjes së hetimeve në kohë. Gjithësesi, kapaciteti investigativ i shërbimit të prokurorisë mbetet i dobët. (*shih gjithashtu seksionin Drejtësia, Liria dhe Siguria*) Mungesa e konsultimit mbi draftin fillestar të ligjit mbi Prokurorinë e Përgjithshme, i cili është ende për tu miratuar, ngriti shqetësime rreth pavaresisë së zyrës së prokurorit të përgjithshem nga ekzekutivi. Në disa raste, qeveria u përpoq të nderhyjë me hetime në vazhdim, duke shkelur parimin kushtetues të përgjegjshmërise përpara ligjit.

Në përgjithësi, pavarësia, transparenca dhe efienca e gjyqësorit mbeten prioritete kyc të Partneritetit Evropian për tu adresuar.

Progres i pjesshëm mund të raportohet në lidhje me mbrojtjen e dëshmitareve. Ligji i vitit 2007 mbi policinë e shtetit bëri të mundur shndërrimin e njësisë së mbrojtjes së dëshmitareve në drejtori. Në këtë moment janë 60 persona që janë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Buxheti i vitit 2008 që i është alokuar programit ka shënuar rritje.

Gjithësesi, ndryshime të mëtejshme në Ligjin për mbrojtjen e dëshmitareve nuk janë miratuar ende. Mungesa e mbrojtjes së besueshme të dëshmitarëve vazhdon të jetë problematike. Nuk mund të raportohen zhvillime në hartimin e një strategjie dhe një organi kombëtar koordinues për gjakmarrjen. Shqipëria ende ka mungesë të dhënash të besueshme mbi numrin e familjeve të prekura nga ky fenomen.

Në përgjithësi, ka pasur progress të kufizuar në refomën e gjyqësorit, kryesisht për sa i përket kuadrin ligjor. Gjithësesi, sistemi i drejtësisë vazhdon të funksionojë dobët për shkak të pengesave për pavarësi, përgjegjshmëri dhe transparencë.

Politika anti-korrupsion

Përpjekje të mëtejshme janë ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit. Perceptimi mbi korrupsionin është përmirësuar; gjithësesi, korrupsioni mbetet një problem vecanerisht serioz në Shqipëri.

Në prill 2008, Ligji mbi ndërmarrjet tregtare u përafhua me Konventën e të Drejtës Civile të Keshillit të Evropës mbi Korrupsionin. Shqipëria ka ratifikuar konventat e të drejtës civile dhe penale të Keshillit të Evropës mbi korrupsionin respektivisht të viteve 2000 dhe 2001. Përafrimi i legjislacionit kombëtar po vazhdon. Protokollin shtesë të Konventës së KE-se mbi të drejtën penale mbi korrupsionin u ratifikua në vitin 2005.

Strategjia kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2007-2013 (SKZHI) permban elemente antikorrupsioni por i mungon një kuadër strategjik për implementimin me objektiva dhe financime që mund të monitorohen. Një strategji nder-sektorale anti-korrupsioni për vitet 2007-2013, me një plan veprimi, u miratua në tetor 2008. Gjithësesi, implementimi duhet filluar dhe mekanizmat e monitorimit mbeten për tu vlerësuar. Shumë punë nevojitet ende në lidhje me ndryshimin e sjelljes dhe procedurave në administratën publike.

Në dhjetor 2007, Grupi i shteteve të KE-se kunder Korrupsionit (GRECO), miratoi raportin e tij mbi Shqipërinë. Njëmbëdhjetë nga trembëdhjetë rekomandimet e GRECO-s janë miratuar, duke përfshirë kriminalizimin dhe sekuestrimin e asetëve që vijnë nga korrupsioni.

Rekomandimet në lidhje me rregullat e financimit të partive politike mbeten për tu adresuar.

Ligji mbi konfliktin e interesave u miratua në vitin 2007. Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Auditimit të Pasurive (HIDAA) është një organ i pavarur i cili mbledh deklaratat e të ardhurave nga zyrtaret publikë. Në raportin vjetor 2007 për parlamentin, HIDAA identifikoi 110 raste konfliktesh interesi. Gjithësesi, Shqipëria i mungojnë autoritete të forta dhe të pavarura për auditimin ose mbikqyrjen. HIDAA luan një rol të kufizuar në këtë drejtim.

Shtrirja e imunitetit në rastet e hetimive penale dhe ndjekjeve të një sere zyretareve shtetëror dhe anetareve të parlamentit, gjithashtu dhe procedurat e vendosura për heqjen e imunitetit të tyre nuk janë adresuar ende. Ligji mbi financimin e partive politike mbetet për tu aprovuar. Përgjegjshmëria e gjyqësorit dhe transparenca në financimin e partive politike mbetet për tu përmirësuar.

Jane bërë përpjekje për të reduktuar mundësitë për korrupsion në fusha si administrata tatimore, shërbimet e biznesit, kthimi i pronave dhe prokurimi publik, dhe duke përdorur sistemin elektronik. Që prej dhjetorit 2007, procedurat elektronike janë futur në tatime, prokurimin publik, licensimin dhe rregjistrimin të bizneseve. Megjithatë, rezultatet dhe impakti i këtyre procedurave mbetet për t'u vlerësuar.

Kuadri institucional dhe koordinimi ndërmjet agjencive në luftën kundër korrupsionit mbetet i dobët. Një Drejtori për Kontroll të Brendshëm Administrativ dhe Anti-Korrupsion brenda Keshillit të Ministrave i raporton direkt Kryeministrit. Gjithësesi, nuk ka një kuadër institucional efektiv për të koordinuar, monitoruar dhe zbatuar politikën anti-korrupsion në administratën publike.

Struktura të tjera të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit kanë pushtet domethenës për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit, por aktivitetet e tyre mbeten gjerësisht të pakoordinuara. Kapaciteti hetimor i organeve të zbatimit të ligjit në rastet e korrupsionit mbetet shumë i kufizuar. *(Shih gjithashtu seksionet mbi drejtësinë, lirinë dhe sigurinë dhe pastrimin e parave)*

Qeveria ka pasur një farë suksesi në luftën kundër korrupsionit të vogël dhe rryshfeteve. Një numër zyrtarësh të nivelit të ulët dhe të mesëm u pushuan për rryshfete. Përveç tyre, Zyra e Kontrollit të Brendshëm (OIC) në Ministrinë e Brendshme, njesia e hetimit të korrupsionit nga oficeret e policisë, ka marrë masa disiplinore ndaj 100 policëve për rryshfete. Qeveria ka rritur përpjekjet për ndjekje penale të disa rasteve të korrupsionit. Në vitin 2007, 224 zyrtarë u identifikuan si të përfshirë në korrupsion dhe konflikt i interesi, 53 prej tyre u arrestuan dhe ndoqën penalisht. Përsa i përket korrupsionit të nivelit të lartë, një ish- zëvendësminister është dënuar me një vit burg. Gjithësesi, një përjasje më sistematike nevojitet për të luftuar korrupsionin në përgjithësi, veçanërisht dhënien e rryshfeteve në gjyqësor, polici dhe sektorët e shëndetësisë dhe doganave.

Shpërthimi i depozitave në municioneve në Gërdec në Mars 2008 është aktualisht nën hetim për një mungesë të supozuar në zbatimin e rregullave shëndetësore dhe të sigurisë. Progres i kufizuar

mund të raportohet në menaxhimin dhe sistemimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe të eksploziveve dhe mbetjeve të luftës, gjë që mbetet një problem serioz në Shqipëri. Dëshmi të tjera që lidhen me aksidentin kanë të bëjnë me trafikun e armëve dhe korrupsionin. Ministri i atëhershëm i Mbrojtjes dha doreheqjen dhe iu hoq imuniteti. Për të siguruar kredibilitet në luftën kundër korrupsionit, pretendimet rreth rastit duhet të trajtohen me vendosmëri si pjesë e hetimeve që po zhvillohen.

Në përgjithësi, Shqipëria ka vazhduar të adresojë korrupsionin, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Gjithësesi, angazhimi i deklaruar i autoriteteve në luftën kundër korrupsionit duhet të mbështetet nga një implementim rigoroz, pasi korrupsioni mbetet i përhapur gjerësisht.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Zbatimi i të ligjit nderkombetar të te drejtave të njeriut

Për sa i perket **ratifikimit të instrumentave të te drejtave të njeriut**, në dhjetor 2007 Shqipëria ratifikoi Protokollin Opsional të Konventes së OKB-se mbi shitjen, shfrytëzimin dhe pornografine e femijeve, dhe femijet në konfliktet e armatosura. Karta Evropiane e Gjuheve Rajonale dhe të Minoriteteve është ende për tu ratifikuar.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (ECtHR) dha pese gjykime ku thuhet se Shqipëria ka shkelur Konventen Evropiane të te Drejtave të Njeriut (ECHR) dhe protokollet qe lidhen me te. Ende janë për tu marre masa për të zbatuar keto vendime. Nje total prej 79 aplikimesh të reja tek ECtHR janë bërë gjatë periudhës së raportimit. Numri total i çështjeve pezull perpara Gjykates në lidhje me Shqiperine është 146.

Shqipëria ka një kuader të gjerë ligjor mbi **promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut** dhe dokumentacioni i qeverise tregon nje vullnet politik për të garantuar të drejtat e njeriut për të gjithë qytetaret e tij. Roli i fortë i luajtur nga avokati i të drejtave të njeriut ka kontribuar në reduktimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjithësesi, zbatimi efektiv i legjislacionit vazhdon të ngreje shqetesime në fushat kyce, si p.sh. parandalimi i tortures dhe trafikimi.

Të drejtat civile dhe politike

Në lidhje me parandalimin e **torturës dhe keqtrajtimit dhe luftës kundër mosndeshkimeve**, ka pasur raportime mbi përdorimin e dhunës së tepruar dhe keqtrajtime nga oficerët e policisë, pjesa më e madhe e tyre gjatë para-burgimit. Gjithësesi, disa përpjekje janë bërë nga Agjencitë e zbatimit të ligjit, për të ndjekur penalisht dhe dënuar rastet e keqtrajtimit, torturës dhe sjelljeve arbitrare. Prokurori i Përgjithshëm ka ngritur padi kundër katër ish zyrtarëve të Shërbimit të Inteligjencës Shteteror. Padi penale janë ngritur dhe masa disiplinore jane marrë kundër oficerëve të policisë për abuzim me postin. Në përputhje me ndryshimet e bër në kodin penal mbi torturën, Avokati i Popullit lancoi në Mars 2008 një fushatë kombëtare për parandalimin e torturës, në bashkëpunim me Qendrën për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës.

Në përgjithësi, hapa të mëtejshëm janë marrë për të parandaluar torturimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, por zbatim më i mire i rregullave të të drejtave të njeriut dhe përndjekje konkrete e abuzimeve ende kërkohet.

Përsa i përket **aksesit në fushën e drejtësisë**, legjislati shqiptar parashikon ndihmë ligjore falas për gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, por sistemi nuk funksionon në mënyrë efektive, vecanërisht për minoritetet, si p.sh. Romet.

Përsa i përket sistemit të burgimit, mbipopullimi i burgjeve dhe qendrave të paraburgimit vazhdoi edhe për vitin 2008. Ka pasur 4,932 të ndaluar në fillim të muajit Maj 2008, pothuajse 1,500 mbi kapacitetin. Ndërtimi i dy burgjeve të rinj (ne Fushë-Kruje dhe Korçë) dhe qendrës së paraburgimit në Vlorë ka përfunduar. Një qendër e re burgimi për të rinjtë në Kavajë dhe një qendër parandalimi së bashku me një facilitet psikiatrik në Durrës janë duke u ndërtuar. Këto ndërtesa të reja, të dizenuara në përputhje me standartet Evropiane duhet të ndihmojnë në reduktimin e mbipopullimit.

Gjithësesi, kushtet e përgjithshme të burgimit mbeten nën standartet. Për shkak të mungesës së hapësirës, raportohet se të burgosurit mbahen në grupe të medha në qeli të vogla ose kthehen në stacionet e policisë.

Të burgosurit me sëmundje mendore janë mbajtur në qeli me të burgosur të tjere ose të miturit janë mbajtur me të rriturit. Progresi në zhvillimin e skemave të rehabilitimit, të tilla si edukimi, puna dhe programet sociale për të burgosurit, ka qenë i kufizuar. Një monitorim efektiv dhe sistem inspektimi për burgjet ende mungon.

Disa burgje janë plotësuar me pajisje për të përmirësuar kushtet e jetesës. Planifikimi i gjashtë qendrave të reja burgimi ka filluar, në përputhje me Master Planin e vitit 2004 për Sistemin e Para-burgimit.

Gjithësesi, qeveria ende ka nevojë të zhvillojë një strategji investimi afatgjatë dhe të alokojë fonde korresponduese nga buxheti i shtetit.

Në Prill 2008, ndryshimet në Ligjin mbi të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve hynë në fuqi, duke përfshirë edhe fazën e paraburgimit. Ndryshime për të zgjeruar dhe lehtësuar aplikimin e denimeve alternative janë hartuar, por janë duke përparuar ngadalë.

Në përgjithësi, progresi i mëtejshëm është bërë në përmirësimin e sistemit të burgimit dhe paraburgimit, por mbipopullimi vazhdon dhe standartet e burgimit mbeten shumë të varfra.

Liria e shprehjes, duke përfshirë atë në media, janë të garantuara nga kushtetuta shqiptare. Megjithatë, perzierja e interesave të biznesit, të politikës dhe të medias vazhdojnë të ndikojnë median e pavarur.

Është duke u përgatitur një ligj i ri për transmetimet. Ai do të ketë një ndikim të madh në mediat në Shqipëri. Në këtë kuadër zbatimi i planit të veprimit të përbashkët të BE/Këshillit të Evropës mbi reformën e legjislatit për median është kryesor. Përgatitja e strategjisë për transmetimet

dixhitale është duke avancuar. Në Prill 2008 u miratua rregullorja për licensimin e transmetimit dixhital. (*Shiko gjithashtu seksionin Shoqëria e Informacionit dhe media*).

Është ushtruar presion i përzgjedhur ndaj medias së orientuar drejt opozitës, duke përfshirë akuza mbi financime të supozuara nga grupe të krimit të organizuar. Mungesa e transparencës mbi pronësinë dhe financimin e ekzpozojnë median ndaj akuzave për influenca kriminale. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) vazhdon të perballlet me akuza për njëanshmëri politike në favor të medias që lidhet me qeverinë. Nuk ka një legjislaçion efektiv që siguron transparencë të pronësisë dhe financimit të medias.

Miratimi i ligjit për të amenduar si Kodin Penal ashtu dhe atë Civil nga shpifje diskriminuese dhe akuza është ende në proces e sipër. Kapaciteti monitorues i KKRT-se është i kufizuar në buletine të reja dhe në njoftime. Kapaciteti teknik i KKRT-së për nevoja më të mëdha monitoruese është duke u forcuar.

Progres i pjesshëm mund të raportohet mbi miratimin e urdheresave mbi politikat e medias. KKRT dhe Parlamenti kanë përgatitur së bashku një plan veprimi mbi reformën e medias dhe kanë hartuar një strategji mbi dixhitalizimin.

Përsa i përket medias së shkruar pak gazeta arritën një numer domethenes lexuesish, kryesisht për shkak të një sistemi mosfunksionues shpërndarje dhe infrastrukture të dobët.

Në përgjithësi, Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres në lirinë e shprehjes, një prioritet kyç i Partneritetit Evropian. Ajo tani ka nevojë të përmirësojë zbatimin e legjislaçionit ekzistues dhe të avancojë në çështje themelore që i përkasin heqjes së shpifjes si vepër penale, miratimi i legjislaçionit mbi aksesin në informacionin publik dhe transparencën mbi pronësinë e medias.

Nuk raportohen kufizime të së drejtës për tu mbledhur dhe organizuar.

Kuadri ligjor për **organizatat e shoqërisë civile** vazhdon të jetë i hapur dhe jokufizues. Organizatat e shoqërisë civile janë duke monitoruar në menyrë aktive respektimin e të drejtave të njeriut dhe përbushjen e detyrimeve të Shqiperisë në kuadër të MSA-së. Megjithatë, angazhimi civil mbetet i ulët. Shqipëria ka një numër të kufizuar të OJQ-ve dhe institutive politike-bërëse me një ndikim të madh. Financimi i shoqërisë civile varet kryesisht nga financimi i donatorëve të huaj. Mekanizmat e koordinimit për të rritur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikë-bërje mbeten të dobët.

Shoqëria civile duhet të rrisë kapacitetet e saj për mbështetje dhe marrdhënie publike, krijimin e rrjeteve dhe zhvillimin e partneriteteve me sektorin shtetëror dhe atë privat. Kapaciteti financiar dhe menaxhues duhet të forcohen, duke synuar në të ardhmen qëndrueshmërinë e sektorit.

Përsa i përket **të drejtës së besimit fetar**, klima e bashkejtesës fetare vazhdon të jetë pozitive dhe reciprokisht tolerante. Megjithatë, kthimi i pronave dhe pasurive të tjera komuniteteve fetare mbetet një çështje që duhet të adresohet si një pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për kthimin e pronave.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

Avokati i popullit vazhdon të luaje një rol aktiv në monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në vitin 2007 institucioni mori 4,233 ankimime nga qytetarë dhe shqyrtoi 2,567 prej tyre. Pjesa më e madhe e ankesave ishin ngritur kundër vendimeve të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Minsitrisë së Drejtësisë dhe gjykatave.

Përsa i përket **të drejtave të grave**, mund të raportohet progres i pjesshëm. Ligji për barazinë gjinore u miratua në Korrik 2008. Strategjia kombëtare mbi barazinë gjinore dhe crrënjosjen e dhunës në familje, së bashku me një plan veprimi trevjecar u miratuan në Dhjetor 2007, duke përfshirë dispozita për gratë e prekura si viktime të trafikut.

Duke iu referuar burimeve të policisë trafikimi ka rënë ndjeshëm në vitin 2007, edhe pse OJQ-të pretendojnë se shume raste kanë mbetur pa u raportuar. Në Maj 2008 u amendua Ligji për Dhunën në Familje. Në Minsitrinë e Punës është ngritur një sektor i ri për dhunën në familje. Autoritetet përgjegjëse, të asistuar nga agjensitë e KB, organizuan aktivitete për forcim kapacitetesh për punonjësit socialë dhe shëndetësorë, autoritetet policore dhe lokale. Megjithatë, strategjia për parandalimin e dhunës në familje nuk është zbatuar për shkak të mungesës së mekanizmave të zbatimit. Numri i grave që kanë vuajtur nga dhuna në familje është domethënës dhe në rritje. Mbrojtja e dëshmitarëve mbetet e ulët me rezultatin që viktimat e trafikimit ngurrojnë të raportojnë trafikuesit e tyre në polici. Shqipëria po avancohet në mënyrë të ngadaltë për integrimin gjinor në punësim dhe në politika të tjera. Ajo që është e nevojshme tani është caktimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatim të plotë të legjislacionit ekszitues.

Në përgjithësi, ka patur progres të mëtjeshëm në forcimin e të drejtave të grave. Megjithate, Shqipëria vazhdon të jetë një vend burimi dhe tranziti për trafikimin e grave, shpesh të të miturve, për shfrytëzim seksual. Trafikimi i grave dhe dhuna në familje mbeten çështje që paraqisin një shqetesim të madh. Për sa i përket të drejtave të fëmijëve, me hyrjen në fuqi në Mars 2008 të Protokollit opsional të Konventes mbi të Drejtat e Femijeve mund të raportohet progres i pjesshem. Parlamenti ka miratuar ndryshimet në Kodin Penal në Prill 2008. ne lidhje me shfrytëzimin e femijeve, i cili tashme konsiderohet si krim.

Ndjekja e procedurave të regjistrimit të lindjeve ka përmiresuar disi frekuentimin e shkollës, aksesin në shërbimet shëndetësore dhe shërbime të tjera sociale të fëmijëve Romë. Pavaresisht zbatimit të projektit për një shans të dytë, përfshirja në shkollë e femijëve romë mbetet e ulët. Procedura të tilla si certifikatat e vaksinimit të detyrueshëm shpesh cojnë në përjashtimin *de facto* nga shkolla.

Përësa i përket drejtësisë për të mitur, gjykata e Tiranës filloi të japë në fund të vitit 2007 dënime me punë në shërbim të komuniteti. Deri në Prill 2008, dënimet me punë në shërbim të komunitetit përbënin 38% të të gjitha dënimeve. Në Mars 2008 u krijuan në gjashtë gjyqe të rretheve kushte të vecanta për minorenët. Janë hartuar amendamente të Kodit Penal, të cilat përfshijnë futjen e sistemit të lirit me kusht. Megjithatë, në rastet që përfshijnë fëmijet, gjyqtarët nuk aplikojnë në mënyrë efikase alternativa të tjera si lirimi me kusht. Lirimi me kusht dhe stazhi janë alternativa të lejueshme për dënimin, por nuk ka punonjës sociale të kualifikuar ose oficerë të lirit me kusht për ti mbikqyrur ata.

Të drejtat e fëmijëve për tu arsimuar janë përmiresuar. Përqindja përfundimtare e përfshirjes në shkollat fillore në 2008 është 92%. Megjithatë, në zonat e populluara nga komunitetet rome, aksesimi mund të ulet deri në 13%. Progresi i pjesshëm është bërë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik. Strategjia për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik u miratua në 2008 si pjesë e një strategjie të re sektoriale për mbrojtjen sociale. Në 2007 u nënshkrua mes Shqipërisë dhe Greqisë një marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj fëmijëve viktimat të trafikimit.

Puna e fëmijëve mbetet gjerësisht e përhapur. Numri i fëmijëve që punojnë në sektorin formal është në rritje (737,000 në 2007 krahasuar me 533,000 në 2006). Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve janë vajza të punësuar në industrinë e përpunimit të peshkut, të këpucëve dhe të veshjeve.

Në përgjithësi, progressi i mëtejshëm është bërë në të drejtat e fëmijëve por duhet të bëhet më shumë për sigurimin e burimeve të përshtatshme për zbatimin e tyre dhe çështjet e punës së fëmijëve.

Përsa i përket **personave vulnerabel dhe/ose atyre të paaftë**, aktualisht përfitojnë nga ndihma sociale 103,000 familje. Në Janar 2008, qeveria miratoi Strategjinë për Mbrojtje dhe Përfshirje Sociale 2008-2013. Ajo përfshin asistencë të re ekonomike për familjet e varfra dhe shërbim social për fëmijët, minoritetet dhe të paaftët, të moshuarit dhe viktimat e trafikimit.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për personat me aftësi të kufizuar ka qene i ngadalte dhe kuadri porcedural nuk është përfunduar akoma. Minsitria e Punës ka hartuar standarte për dhënien e asistencës sociale për personat me aftësi të kufizuar. *(Shiko gjithashtu seksionin Politikat e punësimit dhe sociale)*. Shqipëria nuk ka nënshkruar Konventën e KB mbi të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar. Në fushën e shëndetit mendor, është rikonstruktuar një qendër komunitare dhe janë hapur dy qendra të reja. Megjithatë, zbatimi i ligjit për shëndetin mendor aprovuar në 2007, mbetet i ulët. Nuk ka ende një ligj për dhënien e asistencës ligjore pa pagesë njerëzve me aftësi të kufizuar. Mundësia për tu punësuar mbetet një problem madhor për njerëzit me aftësi të kufizuar.

Në përgjithësi, është bërë progres i mëtejshëm për sa i përket njerëzve vulnerabel nga pikëpamja sociale, por masat për të mbështetur ata mbeten të kufizuara dhe një koordinim më i mirë i institucioneve shtetërore mund të përmiresojë rezultatet.

Përsa i përket **të drejtave të punës dhe sindikatave**, mungesa e një ligji të rishikuar të punës po pengon transferimin e Këshillit Kombëtar të Punës në Këshill Kombëtar Social dhe të Punës. Kjo vonon gjithashtu rishikimin e ligjit që dënon të drejtën për tu ngritur në grevë për disa nëpunës shtetërorë, që nuk është në përputhje me Kartën Sociale Europiane. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim 2007-2013 (SKZHI) parashikon forcimin e dialogut social. Megjithatë, pozicioni i sindikatave dhe organizatave të punëtorëve vazhdon të jetë shumë i ulët dhe dialogu social mbetet në një stad fillestar.

Përsa i përket politikave antidiskriminuese, është bërë progres i pakët në përcaktimin e një përkufizimi ligjor të përshtatshëm të diskriminimit ose të legjislacionit anti-diskriminim. Duhet të sigurohet mbështetje e përshtatshme institucionale për viktimat e dhunës. Ka një qëndrim armiqësor të vazhdueshëm serioz në publik dhe në media ndaj komunitetit të lesbikëve, gay,

biseksualeve dhe transseksualeve (LGBT). Qeveria ndërmori një aksion për të luftuar diskriminimin në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Vazhdojnë arrestime arbitrare dhe keqtrajtme të personave LGBT. Kjo ka cuar në emigracionin e aktivistëve drejtues. Përveç rritjes së përpjekjeve ligjore, tani është i nevojshëm zhillimi i një programi veprimi për të luftuar diskriminimin, duke përfshirë atë në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Përsa i përket të drejtës së pronës, çështjet kryesore mbeten regjistrimi i pasurive të paluajtshme, kthimi i pronave, kompesimi dhe legalizimi i ndërtimeve informale. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPL) ka vazhduar regjistrimin e parë në zona të ndryshme të vendit. Shumë vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë konstatuar shkelje në formën e procedurave të pasakta dhe mungesës së zbatimit të procedurave në kuadër të kthimit dhe të kompensimit. Çështje të pazgjidhura pronësie kanë minuar përpjekjet për të zhvilluar një treg funksional të pronës dhe kanë ulur potencialin e investimeve të huaja. Janë të nevojshme një strategji dhe një plan veprimi i qartë për të zgjidhur problemet e shumta në sektorin e pronave. Janë të domosdoshme amendime ligjore në një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet agjensive dhe ministrive përkatëse.

Agjencia e Regjistrimit dhe Kompesimit të Pronave (ARKP) ka nisur të regjistrojë në një bazë të dhënash elektronike kërkesat për rikthim dhe kompensim. Deri tani, ALUIZNI ka përfunduar hartën vlerësuese të pronave në gjashtë rajone. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave hartat e vlerësimit nuk përfshijnë ende zonat industriale dhe turistike. Një hartë e përfunduar vlerësimi, e cila mbulon secilen zone do të lehtësonte vlerësimin e çështjeve të kthimit dhe kompensimit të pronave.

Në fund të vitit 2007 pronarëve të dikurshëm u eshte bere një kompesim me para në dorë prej €4 milion. Megjithatë, një inventar i tokës së shenjuar për kompensim nuk është bërë akoma. Në vitin 2008 u regjistruan 100,000 ndërtesa informale, kryesisht në periferite e zonave urbane.

Në përgjithësi, është bërë progres i pjesshëm në konsolidimin e të drejtës së pronësise, një prioritet e Partneritetit Evropian. Ajo që nevojitet tani është përshpejtimi i ritmit të kthimit dhe kompensimit. Përgatitjet në këtë fushë janë duke avancuar ngadalë.

Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

Përsa i përket, **të drejtave kulturore**, kushtetuta mbron të drejtat civile, ekonomike, sociale dhe politike të grupeve minoritare dhe ligji parandalon trajtimin diskriminues. Personat që i përkasin minoriteteve kanë të drejtë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Në Shqipëri ka tre minoritete kombëtare të njohura (greke, maqedonase dhe serbo-malazeze) dhe dy minoritete etno-linguistike (arumunet dhe romët). Komuniteti egjiptian synon statusin e nje minoriteti etno-kulturor. Qeveria ka bere përpjekje për ta perfshirë atë në aktivitete të ndryshme për minoritetet dhe grupet sociale vulnerabël. Zhvillimi i politikave të minoriteteve kërkon statistika të rifreskuara për të gjitha minoritetet. Shqipëria nuk ka të dhëna të sakta për minoritetet.

Shqipëria vazhdon të bëjë përpjekje për të përmbushur angazhimet e saj që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare vecanërisht për sa i përket përdorimit të gjuhës së minoriteteve dhe edukimit. Megjithatë, janë të nevojshme përpjekje të mëtejshme për zbutjen e tensioneve ndërmjet etnive në fushat me një përqendrim

të madh të minoriteteve. Për shkak të pamundësive financiare Shqipëria nuk ka nënshkruar Kartën Europiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve.

Shkollat për anëtarët e minoritetit grek dhe maqedonas kanë një raport nxënës-mësues domethënës e më të lartë në krahasim me nivelin kombëtar. Raporti nxënës/mësues është afërsisht 6.9/1 për minoritetin grek dhe 12.6/1 për minoritetin maqedonas duke e krahasuar me raportin kombëtar 18/1. Megjithatë, në disa zona me një përqendrim të lartë të minoriteteve, shkollat publike që i ofrojnë minoriteteve etnike edukim minoritar nuk janë të mjaftueshme. Në Tiranë, Korçë dhe Himarë janë ngritur tre shkolla private shqiptaro-greke. Ligji i Administratës Publike lejon pjesëmarrjen e minoriteteve në administratën publike, në forcat e armatosura dhe në polici. Megjithatë, përfaqësimi i minoriteteve është i ulët.

Në përgjithësi, është bërë progres i mëtëjshëm për të drejtat kulturore por nevojiten përmirësime të mëtëjshme, vecanërisht për sa i përket mbledhjes së të dhënave të plota për të gjitha minoritetet, një prioritet i Partneritetit Evropian.

Në Prill 2008 Shqipëria aderoi në Dekadën e Përfshirjes së **Romëve** 2005-2015. Është duke u përgatitur një plan veprimi përkatës. Në Dhjetor 2007 u publikua Progres Raporti i parë mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për integrimin e romëve, duke treguar burime të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e saj të përshtatshëm. Sektori i ngarkuar për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Romëve në Ministrinë e Punës dhe Cështjeve Sociale (MPCS) është përmirësuar me një sekretariat teknik. Kjo do të përmirësojë kapacitetin e tij për të monitoruar dhe koordinuar masat me institucione të tjera. Një prej punonjësve të stafit është përfaqësues i komunitetit rom. Megjithatë, sekretariati, i përbërë prej dy personash, është me personel të pamjaftueshëm për të kryer detyrat e tij. Perpjekjet duhet të pershpjetoohen për të koordinuar Planin e Veprimit të Dekatës së Romëve me strategji të tjera ekzistuese dhe siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ta zbatuar atë.

Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për të lehtësuar regjistrimin dhe zbatimin e një projekti për një shans të dytë niveli i përfshirjes në shkollë të fëmijëve romë mbetet i ulët. Duhet të bëhet më shumë për të trajtuar çështje specifike gjinore në komunitetin e romëve dhe për të përgatitur më shumë romë si mësues. Regjistrimi i romëve në autoritete mbetet një problem.

Romët vazhdojnë të përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim, me akses të dobët për edukim, mbrojtje sociale, shërbim shëndetësor, strehim dhe punësim.

Në përgjithësi, është bërë një progres i pjesshëm për sa i përket masave të marra nga qeveria për të përmirësuar situatën e romëve, e cila mbetet një shqetësim serioz. Ajo që nevojitet tani është sigurimi i burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të zbatuar këto masa në mënyrë efektive.

2.3. Çështje rajonale dhe detyrime ndërkombëtare

Për sa i përket Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), Shqipëria vazhdon të ketë në fuqi marrëveshjen bilaterale të Qershorit 2003 me SHBA mbi përjashtimin të shtetasve Amerikane nga juridiksioni i GjND. Kjo nuk është në përputhje me pozicionin e përgjithshëm të BE mbi

integritetin e statutit të Romës apo me parimet bazë të BE mbi marrëveshjet bilaterale të imuniteteve. Në këtë rast është e nevojshme që pozicioni i Shqipërisë të përpulhet me atë të BE-së.

Shqipëria vazhdon të monitorohet nga Asambleja e Këshillit të Evropës, për të verifikuar zbatimin e detyrimeve dhe angazhimeve në lidhje me anëtarësimin e saj në këtë organizatë. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të procesit drejt Integritimit në BE.

Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në një numër forumesh dhe iniciativash, përfshirë këtu edhe kalimin nga Pakti i Stabilitetit në një kuadër më rajonal në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) si dhe Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit (RCC).

Shqipëria ka zbatuar kënaqshëm marrëveshjen mbi Tregtinë e lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe është duke ecur përpara në fazën e parë tranzitore të marrëveshjes mbi zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA). Shqipëria është pjesë e traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe është duke bërë hapa përpara në plotësimin e detyrimeve të bazuara mbi traktatin.

Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e procesit të Barcelonës që nga Nëntori 2007 dhe ka marrë pjesë në nismën e procesit të Barcelonës: Bashkimi për Mesdheun në Korrik 2008.

Marrëdhëniet bilaterale të Shqipërisë me vendet e tjera që përfshihen në zgjerim si dhe me vendet anëtare fqinje, kanë qëndruar intensive, me kontakte dhe vizita bilaterale të shpeshta. Marrëdhëniet me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kanë vazhduar të jenë të mira, me vizita reciproke të rangjeve të larta, me konkludimin e një regjimi të lirë vizash, bashkëpunimit lokal mbi lëvizjet ndërkufitare si dhe kontrollit të kufijve.

Marrëdhëniet me Malin e Zi janë zhvilluar më tej. Ka filluar puna në ndërtimin e një pike kufitare të përbashkët në Muriqan/ Sukobinë. Gjithashtu janë intensifikuar marrëdhëniet me Bosnje-Hercegovinën. Kjo e fundit ka vendosur hapjen e një ambasade në Tiranë. Shqipëria vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me Kroacinë. Marrëdhëniet me Serbinë kanë qenë të qëndrueshme. Marrëdhëniet me Turqinë kanë vazhduar të jenë të mira. Marrëveshja e Tregtisë së lirë me Turqinë ka hyrë në fuqi.

Shqipëria ka vazhduar të mbajë pozicionin e saj konstruktiv në lidhje me Kosovën. Shqipëria ka mirëpritur vendimin mbi vendosjen e misionit të BE në Kosovë. Shqipëria ka njohur deklaratën e pavarësisë së Kosovës dhe ka vendosur me të marrëdhënie diplomatike.

Italia mbetet partneri kryesor politik dhe ekonomik i Shqipërisë, si dhe partneri kryesor në tregtinë me BE, i ndjekur nga Greqia e cila konsiderohet gjithashtu si një partner strategjik. Gjithashtu me Italinë është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe mbi asistencën juridike në lidhje me çështjet penale.

Shqipëria ka marrë një ftesë për t'u anëtarësuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), dhe protokollin e anëtarësimit në Traktatin e Ëashington-it është nënshkruar.

Në përgjithësi, Shqipëria ka vazhduar të nxisë marrëdhënie pozitive me fqinjët si dhe me partnerët e saj rajonalë si në marrëdhëniet dypalëshe ashtu dhe në ato shumëpalëshe. Shqipëria ka vijuar të ketë një qëndrim konstruktiv mbi çështjen e Kosovës dhe ka vazhduar të ketë

marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me vendet e tjera që përfshihen në zgjerimin e BE dhe ka kontribuar në stabilitetin rajonal.

3. KRITERI EKONOMIK

Gjatë analizës së zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, qasja e Komisionit Evropian është drejtuar nga përfundimet e Këshillit të Evropës në Qershor 1993, të cilat theksojnë që anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe të kapaciteteve për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe të forcave të tregut brenda Unionit.

3.1 Ekzistenca e një Ekonomie Tregu Funksionale

Elementët kryesorë të Politikës Ekonomike

Qeveria dorëzoi programin Ekonomik dhe Fiskal për vitet 2007-2010 në Dhjetor 2007, duke përcaktuar një kuadër koherent për politikën ekonomike të qeverisë. Kjo politika vazhduan të mbështesin vendosjen e një ekonomie tregu funksionale por në disa raste treguan dobësi, për shkak të mungesës së planeve të detajuara të veprimit. Strategjitë ekonomike ishin përgjithësisht të përputhshme me programin tri vjeçar 2006-2009 PRGF/EFF4 të Fondit Monetar Ndërkombëtar në vend.

Në vitin 2008, qeveria zgjeroi strategjinë e saj afatgjatë duke adaptuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (NSDI) për vitet 2007-2013 e cila u përgatit në konsultim me aksionarët vendas dhe të huaj. Në linjë me sistemin e planifikimit të integruar (IPS), qeveria gjithashtu adaptoi një kuadër fiskal dhe Makroekonomik 2009-2011 dhe programin e Buxhetit afat-mesëm 2008-2010. Në përgjithësi konsensusi politik mbi themelet e Ekonomisë së Tregut u zgjerua më tej, por planifikimi i tij në një fushë shumë të gjerë rrezikoi shpesh herë zbatimin e reformave ekonomike.

Stabiliteti Makroekonomik

Ekonomia përjetoj një rritje të fortë, pavarësisht thatësisë së verës të vitit 2007 që shkaktoi ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike. Investimet e gjera si dhe konsumi i lartë, çuan në një rritje ekonomike prej 6% në terma realë në vitin 2007- Rritja më e madhe ekonomike që nga viti 2002. Aktiviteti ekonomik u fuqizua nga një rritje e qëndrueshme edhe pse e ngadaltë e kredive si dhe nga të ardhurat e vazhdueshme nga jashtë (12% e PBB). Furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike vazhdoi të përbëjë një risk të vazhdueshëm për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë. Të ardhurat mesatare për frymë në vitin 2007 ishin rreth 22 % të mesatares së EU 27, nga 21% të vitit 2006. Në përgjithësi rritja ekonomike qëndroi e fortë ndërsa niveli i të ardhurave qëndroi i ulët.

Deficiti tregtar u përkeqësua duke arritur 10,6 % të PBB në vitin 2007 nga 6,5 % të vitit 2006. Deficiti u shtua kryesisht nga deficiti tregtar (26,8 % të PBB në vitin 2007), pavarësisht rritjes së eksporteve. Importet e larta të energjisë (30% i rritjes totale të importeve në vitin 2007), të shkaktuara nga një thatësi e zgjatur dhe nga kërkesa për makineri, kontribuan fuqimisht në rritjen e përgjithshme të importeve.

Eksportet qëndruan më shumë se 3,5 herë më të ulëta se importet, pavarësisht rritjes së fortë të eksporteve të mineraleve.

Deficiti tregtar vazhdoi të thellohej në gjysmën e parë të 2008, për shkak të sasisë së lartë të importeve. Teprica në tregtinë e shërbimeve qëndroi e kufizuar dhe tepricat nga të ardhurat dhe transfertat e parave (përfshirë dhe ato nga jashtë) ishin më të ulëta se në vitin paraardhës. Në përgjithësi, deficiti tregtar qëndroi i lartë dhe vazhdoi të rritej.

Të ardhurat neto të kapitaleve u rritën, duke mbuluar deficitin e vitit 2007. Investimet e huaja direkte arritën 5,9 % të PBB në 2007 (nga 3,5% të 2006), të mbështetura nga të ardhurat që erdhën si pasojë e privatizimit të sektorit të telekomunikacioneve. Të ardhurat e tjera (kryesisht nga kreditë e marra nga sektori privat dhe depozitat e emigrantëve) u rritën duke zënë 3,2 % të PBB në vitin 2007. Sidoqoftë nga katër mujori i fundit i 2007 e tutje, deficiti tejkaloi të ardhurat neto duke çuar në një ulje të aseteve rezerve. Stoku i aseteve rezervë qëndroi në nivelin e 3,3 muajve të importeve të mallrave dhe shërbimeve të fund-qershorit 2008.

Përqindja e borxhit të jashtëm në PBB ra në 24,8 % të fund 2007 (25,1% në 2006), me rënien e kuotës së borxhit të jashtëm publik në 15,4 % të PBB. Borxhi i jashtëm i sektorit financiar u rrit ndjeshëm (me 50%) për shkak kredive afat shkurtra dhe depozitave të jo-rezidentëve.

Borxhi i sektorit të ndërmarrjeve qëndroi i kufizuar (me stoqe që ranë deri në 5 % të PBB). Në total, të ardhurat neto u rritën, por qëndruan relativisht të ulëta.

Paniku i fundit në tregjet globale të financave rriti rreziqet ndaj ekonomisë Shqiptare. Rreziqet në sektorin financiar rriten edhe si pasojë e nivelit të ulët të ndërmjetësimit financiar si dhe nga integrimi i kufizuar në tregjet ndërkombëtare të kapitaleve. Ndërkohë sektori bankar është i financuar mirë dhe i mbështetur nga depozitat e familjarëve. Gjithsesi, rritja e vazhdueshme e sasisë aktuale të deficitit kërkon rritje të kapitaleve që mund të përdoren në rast të uljes së rritjes ekonomike globale.

Kushtet e tregut të punës u përmirësuan gjatë 2007. Numri i të papunëve të regjistruar u ul, duke shkaktuar një ulje të papunësisë (13,4 % në 2007 dhe 13 % në Mars 2008, nga 13.9 % në 2006). Numri i të punësuarve u rrit si pasojë e punësimit të lartë në sektorin privat jo-Bujqësor. Në total, krahu i punës (shuma e të punësuarve dhe e të papunëve) u ul në rreth 0.4 %, duke treguar kështu lëvizjen e disa të papunëve drejt inaktivitetit.

Pagat në sektorin publik u rritën deri në 17,1 % krahasuar me rrogën mesatare të vitit 2007, në mënyrë të theksuar më shumë se në 2006 (7.5%), por nuk arritën t'i përgjigjeshin kërkesës së brendshme dhe inflacionit. Në përgjithësi performanca e tregut të punës u përmirësua, por ngurtësia e tregut vazhdoi të mbetet e dukshme.

Megjithatë, për shkak të ekonomisë informale, të dhënat e tregut të punës nuk reflektojnë dot saktësisht dinamikën aktuale të tregut të punës.

Banka qendrore vazhdoi të zbatojë politikën e inflacionit implicit duke iu drejtuar huave. Objektivi i mbajtjes së inflacionit në 3 % , me një marzh ndryshimi në ± 1 % u arrit, me një inflacion që arriti 2.9% në 2007.

Presioni potencial i kërkesës dhe presionet që vijnë nga rritja e çmimeve në tregjet globale u trajtuan duke rritur interesat në politikat monetare kyçe.

Në gjysmën e dytë të 2007, Banka Qendrore rriti interesat tri herë (nga 0.75% në 6.25 %). Në tre çerekun e parë të 2008, inflacioni qëndroi në përputhje me objektivin e vendosur, megjithëse në disa muaj ai i kaloi 4%. Shkaktarët e inflacionit ishin çmimet e ushqimeve dhe të energjisë. Rritja e çmimit të ushqimeve përbën dy të tretën e inflacionit vjetor. Ndikimi i presioneve të kërkesës ishte i kufizuar, pavarësisht rritjes së kredive dhe të ardhurave nga jashtë. Rritja e të ardhurave (M37) mbeti relativisht e lartë (14% vit pas viti në Korrik 2008). Çrregullimet në nivelin e shkëmbimit në Euro mbetën të kufizuara, me disa zhvleftësime të vogla të Lekut në Mars 2008. Në përgjithësi, politikat monetare ishin stabile duke mbajtur konstante qëndrueshmërinë e çmimeve.

Gjendja fiskale u dobësua në 2007, pavarësisht fuqizimit të rritjes ekonomike. Bilanci fiskal u keqësua me deficitin që pësoi një ngritje prej 3.5% të PBB në 2007- nga 3.3 % në 2006. Politikat fiskale vijuan të ndiqnin praktika zgjeruese, me planet e buxhetit që projektonin deficite edhe më të larta, kryesisht nga projektet e mëdha për investime publike.

Niveli i borxhit publik ra në 53% në fund të vitit 2007 nga 56% në 2006. Ndërkohë që borxhi publik i brendshëm ra në 37.6 % të PBB. Sidomos në vitin 2008, mbështetur edhe nga reformat në shkallë të gjerë në fushën tatimore që gjithashtu kontribuuan në zgjerimin e bazës tatimore, menaxhimi i financave publike u përmirësua ndjeshëm.

Aplikimi i taksës së sheshtë 10 % për të ardhurat, u shoqërua nga një rritje e të ardhurave nga taksat.

Niveli i menaxhimit të financave të pushtetit vendor vazhdoi të mbetet i dobët, duke ndikuar kështu në uljen vjeljes së të ardhurave dhe në shpenzime të kufizuara.

Shpenzimet publike ndoqën prioritetet strategjike të investimeve publike që do të pësonin rritje duke përmbajtur në të njëjtën kohë rritjen e shpenzimeve korrente. Shpenzimet për personelin u mbajtën në kuotën 6% të PBB dhe interesat e shpenzimeve u ulën në 2.6% të PBB në 2007, pjesërisht si pasojë e një menaxhimi efikas të borxhit. Investimet publike u rritën në 5.8% të PBB, por zbatimi i dobët i tyre mbajti shpenzimet e kapitalit nën parashikimet e bëra. Për sa i përket strategjive fiskale, buxheti i vitit 2008 projektoi një rënie të thellë të bilanceve fiskale me një deficit prej 7.9% të PBB, si pasojë e shpenzimeve të mëdha të kapitaleve që shkuan deri në 9.8% të PBB.

Një rishikim i buxhetit në mesin e 2008, uli deficitin në 5.2 % duke rritur të ardhurat dhe duke shkurtuar investimet publike. Për sa i përket të ardhurave, ulja e taksës mbi fitimin nga 20 % në 10 % në Janar 2008, solli një ndryshim në strukturën e të ardhurave publike. Të ardhurat nga taksat mbi ndërmarrjet u ulën, por u kompensuan nga rritja e akcizës. Në përgjithësi, administrimi i financave publike u përmirësua, por gjendja fiskale u dobësua si pasojë e planeve ambicioze për investimet publike.

Politikat makroekonomike, të cilat në përgjithësi kushtonin vëmendje reformave strukturale, rezultuan si të përshtatshme. Politika monetare mbeti stabile, ndërsa strategjitë fiskale i vunë më shumë rëndësi investimeve mbi konsolidimin fiskal. Zgjerimi i çekuilibreimeve fiskale mund të sjellë instabilitet dhe të ndalojë politikat fiskale të luajnë rolin e tyre. Brishtësitë e deficitit

tregtar u shtuan, duke kërkuar masa të rrepta për furnizimin me energji elektrike, zgjerimin e bazës së eksporteve si dhe një atmosferë më tërheqëse investimesh.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Pjesëmarrja e shtetit në ekonomi mbetet e kufizuar ndërsa sektori privat zë rreth 80 % të PBB. Punësimi në sektorin privat u rrit në 82.1 % në 2007 (nga 81.9 % në 2006). Ndërmarrjet publike vazhduan të jenë të pranishme më shumë në sektorin e shërbimeve dhe në bujqësi. Privatizimi i ndërmarrjeve strategjike ka ecur ndjeshëm përpara. Është aprovuar kontrata për shitjen e 85% të aksioneve të rafinerisë së ARMO dhe ka filluar procesi i privatizimit të sektorit të shpërndarjes (OSSSH) së energjisë elektrike në KESH. Gjithashtu qeveria ka përmbyllur disa tendera për konsulencën në lidhje me privatizimin e 12.6 % të aksioneve të AMC, dhe të pjesës më të madhe të kompanisë INSIG. Ndërkohë që Privatizimi i Albpetrol (kompania e përfshirë në nxjerrjen, kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës) është shtyrë. Në përgjithësi reduktimi i pronësisë shtetërore në ekonomi ka avancuar, ndërkohë që kompanitë e mëdha inefektive shtetërore që kanë mbetur, vazhdojnë të sjellin çrregullime në treg.

Hyrja dhe dalja në treg

Qeveria ka thjeshtëzuar ndjeshëm procedurat e regjistrimit të biznesit. Krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve (QNK) ka ulur kohën e regjistrimit të biznesit në një ditë dhe njëkohësisht ka mundësuar regjistrimin simultan për qëllimin e administratës tatimore, sigurimeve sociale dhe të shëndetësisë, si dhe të inspektoratit të Punës. Taksat e regjistrimit u ulën në një euro. Infrastruktura për regjistrimin e biznesit u përmirësua duke rritur numrin e shërbimeve elektronike si dhe ngritjen e qendrave të regjistrimit në të gjithë vendin.

Kuadri i përmirësuar i shërbimeve, së bashku me inspektimet rigorozë nga autoritetet, adresuan menyra për të reduktuar fenomenin e informalitetit në biznes. Procedurat e thjeshtëzuara shënuan një rrije në numrin e përgjithshëm të bizneseve. Gjithashtu qeveria vazhdoi reformën rregullatore të licencimeve duke thjeshtëzuar procedurat e licencimeve si dhe duke reduktuar numrin e licencave. Sidoqoftë ka ende vend për thjeshtëzim të mëtejshëm. Probleme të rëndësishme janë lejet e ndërtimit, të cilat ranë në masën 40 % në vitin 2007.

Për sa i përket procedurave të daljes, ligji i ri mbi procedurën e falimentimit u aprovua në Maj; kjo ka sjellë një kuadër ligjor mjaft efikas për daljen nga biznesi, duke u nisur edhe nga fakti që në vitet e fundit nuk është regjistruar asnjë procedurë falimentimi nëpër gjykata. Në përgjithësi procedurat administrative nëpër gjykata janë thjeshtëzuar ndjeshëm. Megjithatë ka ende vend për përmirësime.

Sistemi Ligjor

Qeveria ndërmori një sërë hapash në drejtim të fuqizimit të sistemit të drejtësisë dhe në luftën kundër korrupsionit. Një numër shërbimesh elektronike publike (përfshirë edhe sistemin elektronik të prokurimeve publike) u krijuan për të rritur traspencën. Reforma e përgjithshme në Drejtësi vazhdoi me adoptimin e ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e Gjyqësorit.

Filluan inspektimet ne Gjykatat dhe agjencitë publike dhe procedimet ligjore filluan të ndërmerreshin ndaj zyrtarëve përgjegjës për shkeljet. Siguria ligjore u rrit si pasojë e vendosjes së bazës ligjore për krijimin e një tipi të ri të gjykatave administrative të cilat do të venosnin mbi ceshtjet tregtare dhe mosmarrëveshjeve midis kompanive dhe institucioneve publike. Përgatitja për përcaktimin e të Drejtave të Pronësisë ka shënuar progres.

Zyrat në zonat kadastrale ishin të përgatitura për regjistrimin fillestar të tokës dhe puna përgatitore për dixhitalizimin e hartave mbaroi. Sidoqoftë, kërkohet më shumë punë në lidhje me luftën kundër korrupsionit që ndikon në klimën e biznesit dhe që ka një efekt negative në cilësinë e shërbimeve publike.

Në përgjithësi është përforcuar kuadri ligjor i zbatimit të kontratave, por gjyqësori vazhdon të mbetet i dobët dhe paqartësia në lidhje me të drejtat e pronësisë mbi tokën vazhdon të ekzistojë.

Zhvillimi i Sektorit Financiar

Ndërmjetësimi financiar është zgjeruar ndjeshëm, por niveli i tij ka vijuar të qëndrojë i ulët. Huat bankare në sektorin privat u rritën në 31.4 % të PBB në Qershor 2008 (nga 21.4 % në fund të 2006), rezervat e parave qëndruan në nivelin e 70 % të PBB. Pjesëmarrja e ndërmjetësve të tjerë vazhdoi të qëndrojë e ulët, asnjë kompani vendase nuk është regjistruar në bursën e Tiranës dhe asnjë progres nuk është arritur në fondin e pensioneve të sektorit privat.

Miratimi i ligjit mbi sigurimet ka krijuar një bazë për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të kapitaleve. Kompanitë e sigurimeve vazhduan të jenë ndërmjetësit kryesorë në sektorin financiar me asete që shkon deri në 2 % të PBB. Sektori Banka është i gjithi në dorën e sektorit privat, dhe pjesëmarrja e kapitalit të huaj është rritur deri në 99%. Pas një shkrirjeje midis dy bankave, numri i tyre u ul në 16. Konkurrenca në sektorin bankar u rrit, ndërkohë që përqendrimi i aseteve ra ndjeshëm. Normat e fitimit të bankave qëndruan relativisht të larta (vlera e aseteve u rrit në 1.3 % në Qershor 2008 krahasuar me fundin e 2006).

Bankat vazhduan të zgjeronin numrin llojit të kredive si dhe numrin e degëve lokale. Në përgjithësi ndërmjetësimi financiar u dominua nga sektori bankar që ka funksionuar mirë. Ai është rritur me një ritëm të shpejtë, ndërkohë që roli i sektorit financiar jo bankar ka mbetur i kufizuar.

Stabiliteti i sektorit financiar ka qëndruar i kënaqshëm. Ai është mbështetur nga klima e favorshme ekonomike dhe mbikëqyrja financiare më e konsoliduar. Në aspektin e përshtatshmërisë kapitalet qëndruan mbi minimumin e kërkuar (me raporte nga 17.3 në 12 % respektivisht në Qershor 2008), Cilësia e kredive qëndroi relativisht e lartë dhe pjesëmarrja e huave të këqija në huadhënie vazhdoi të qëndrojë e ulët edhe pse arriti kuotën 4 % në Mars 2008 (nga 3.1 % në fund 2006).

Rritja e ngadaltë kredive dhe fakti që një pjesë e madhe e kredive është e dominuar nga valutat e huaja janë faktorë që kërkojnë përkujdesje të vazhdueshme në rreziqet që rrjedhin nga kreditë. Krijimi i një regjistri të kredive ka sjellë transparencë në sistemin bankar. Në përgjithësi sistemi financiar ka qëndruar i fortë duke adresuar rreziqet që vijnë nga një rënie e mundshme e kualitetit të kredive.

3.2 Aftësia për t'u përballur me trysnitë e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda BE

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Stabiliteti makroekonomik në përgjithësi ka qenë i qëndrueshëm duke i dhënë në këtë mënyrë agjentëve ekonomikë një klimë të mirë në vendimmarrje. Funksionimi i mekanizmave të tregut vazhdoi të kishte mangësi serioze si pasojë e furnizimit të pasigurt me energji, sistemit gjyqësor të dobët, paqartësisë në të drejtat e pronës dhe mungesës së efikasitetit në kuadrin ligjor aktual për bizneset.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Reformat për përmirësimin e cilësisë së krahut të punës kanë vazhduar me theks të veçantë në trajnimin profesional. Qeveria adoptoi një strategji mbi punësimin dhe trajnimin profesional, duke synuar uljen e papunësinë poshtë mesatares së BE deri në vitin 2013. Paralelisht me këtë është krijuar Këshilli Kombëtar për arsimin parauniversitar. Gjithashtu janë hartuar manuale për shkollat e mesme si dhe janë krijuar standardet për arsimin post universitar. Në total shpenzimet publike për arsimin u rritën në 3.3 % të PBB në vitin 2007 (nga 2.9% në 2006).

Për promovimin e punësimit, qeveria ka vendosur një kompensim të pjesshëm për kostot e trajnimit dhe një kompensim të përkohshëm për kontributet e sigurimeve shoqërore për kompanitë që punësojnë punëkërkues të papunë. Vlerësimi i duhur i impaktit të masave të marra në tregun e punës vazhdon, të pengohet nga statistikave të kufizuara dhe pjesërisht kontradiktore mbi tregun e punës.

Në përgjithësi janë krijuar mundësi për rritjen e cilësisë së nivelit relativisht të ulët të kapitalit njerëzor, por ndikimi i tyre në tregun e punës mbetet i paqartë.

Akumulimi i kapitalit fizik vazhdoi në një nivel të krahasueshëm me atë të vitit 2006, edhe pse më i ngadaltë se në vitet e mëparshme. Proporcioni i investimeve totale me PBB ishte 29.2 % në 2007. Të ardhurat nga investimet direkte neto (IDN) u rritën ndjeshëm (5.9% të PBB në 2007), kryesisht si pasojë e hyrjeve nga privatizimi i sektorit të telekomunikacioneve. Hyrjet nga IDN-të ishin gjithashtu të konsiderueshme në sektorin financiar. Stoku total i IDN-ve qëndroi relativisht i ulët duke arritur 19.1 % të PBB në 2007. Infrastruktura vazhdon të jetë e dobët pavarësisht investimeve të konsiderueshme në rrjetin e rrugëve. Përgatitjet për rikonstruktimin hekurudhave kanë ecur përpara.

Energjia e bazuar në hidroenergji vazhdon të ketë mungesa në kapacitetin për të plotësuar kërkesën e brendshme. Numri i marrëveshjeve koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla është rritur dhe ka filluar ndërtimi i një Termocentrali. Sidoqoftë këto masa do të sjellin vetëm një zgjidhje të pjesshme për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike. Në përgjithësi akumulimi i kapitalit ka vazhduar, por stoku i kapitalit ka mbetur i kufizuar.

Struktura e sektorëve dhe ndërmarrjeve

Ristrukturimi i ndërmarrjeve ka vazhduar në sektorët në pronësi të shtetit, kryesisht si përgatitje për privatizim. Në sektorin e prodhimit të naftës, restrukturimi i rafinerisë së ARMO dhe prodhuesit të naftës Albpetrol kanë ecur përpara dhe një plan investimi për rafinerinë e naftës i është dorëzuar qeverisë si një dokument detyrueshëm për procedurat e tenderimit.

Në sektorin e energjisë elektrike kanë shënuar arritje përgatitjet për restrukturimin dhe privatizimin e kompanisë me humbje të energjisë elektrike KESH. Gjithsesi, tarifatat e rrymës elektrike kanë vazhduar të jenë nën koston efektive të prodhimit duke kontribuar në këtë mënyrë në humbje financiare. Furnizimi me energji vazhdoi të jetë i paqëndrueshëm. Në përgjithësi, rikonstruktimi i ndërmarrjeve ka avancuar por ndryshime të tjera shtesë janë të nevojshme për të rritur konkurrueshmërinë e monopoleve aktuale shtetërore. Struktura sektoriale e ekonomisë nuk pësoi ndryshime dhe prodhuesi kryesor vazhdoi të ishte sektori i shërbimeve. Sektori i minierave kontribuoi konsiderueshëm në shtimin total të prodhimeve dhe eksporteve edhe pse përqindja e tij në totalin e prodhimit dhe në eksporte vazhdoi të qëndronte e ulët. Sektori i Bujqësisë mbeti punëdhënësi më i madh me mbi 58% të totalit të punëmarrësve, por kontributi në ekonomi zinte vetëm 20.7 % të PBB (për detaje shihni Aneksin). Sektori informal qëndroi i konsiderueshëm. Në përgjithësi ekonomia ruajti strukturën e saj me qëllimin për të zgjeruar më tej sektorët e shërbimeve dhe të industrisë në dëm të bujqësisë inefektive.

Influenca e shtetit në konkurrueshmëri

Qeveria mbajti transfertat e subvencioneve nga buxheti qëndror në një nivel relativisht të ulët (0.4% të PBB në 2007). Tarifatat e energjisë, të cilat përcaktohen nga shteti, qëndruan nën koston duke krijuar subvencione indirekte për konsumatorët. Rritja e fundit e çmimeve të naftës shkaktoi një përjashtim nga taksat e akcizës në karburantet për prodhuesit në sektorin bujqësor dhe industrial si dhe për disa prodhues të energjisë. Në përgjithësi shtrembërimet e konkurrueshmërisë që vijnë nga ndërhyrja e shtetit u mbajtën nën kontroll, ndërsa çështjet rreth sektorit të energjisë vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura.

Integrimi ekonomik në BE

Hapja e ekonomisë është rritur ndjeshëm, kryesisht nga totali i tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime që arritën 81% të PBB në 2007 (krahasuar me 72% në 2006). Tregtia u rrit konsiderueshëm si pasojë e rritjes së importeve, ndërsa konkurrueshmëria e eksporteve vazhdoi të jetë e dobët (me eksportet e mallrave dhe të shërbimeve që përbënin përkatësisht 10 % dhe 18 % të PBB në 2007).

BE vazhdoi të jetë partneri kryesor i tregtisë , ndërkohë që përqindja e tregtisë së mallrave me BE zbriti në 64 % (nga 69%). Rënia erdhi pjesërisht si rezultat i rritjes së tregtisë me vendet e CEFTA, por kryesisht nga rritja e eksporteve të sektorit mineral në Azi.

Konkurrueshmëria e dobët në tregtinë me BE vazhdon të reflektohet nga përqendrimi i theksuar i partnerëve të eksportit (më shumë se dy të tretat e totalit të eksporteve të mallrave janë të destinuara për Itali). Importet (gjithashtu edhe si partnerët tregtarë) vazhduan të tregonin një tablo mikse, ku dy partnerë tregtarë zinin 50 % të importeve totale. Në përgjithësi, BE vazhdoi të ishte partneri kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike, ndërsa integrimi ndërkombëtar i përgjithshëm mbeti i kufizuar.

4. STANDARTET EVROPIANE

Ky seksion analizon kapacitetet e Shqipërisë për përafrimin gradual të legjislacionit të saj dhe politikat në lidhje me *acquis* për sa përket tregut të brendshëm, politikat sektoriale dhe Drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Ai gjithashtu analizon kapacitetet administrative të Shqipërisë. Në çdo sektor, vlerësimi i komisionit mbulon progresin e arritur gjatë periudhave të raportimit dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjes së vendit në fusha të caktuara.

4.1 Tregu i Brendshëm

4.1.1 Lëvizja e lirë e mallrave

Progres i mirë është arritur në standardizim. Në fund të shatorit 2008, Shqipëria adoptoi 14,124 Standarde Evropiane (ENs), ose 84.3 % të të gjitha standardeve të adoptuara nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN) dhe nga Komiteti për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC). Kjo tejkalon synimin prej 80 % që ishte vënë për vitin 2008. Drejtoria e Përgjithshme për Standardizimin (DGS) ka përdorur mjete të ndryshme proporcionale për të rritur ndërgjegjësimin e sektorit privat për përparësitë e standardizimit. Kjo ka sjellë në një rritje të përdorimit të standardeve (janë shitur 117% më shumë standarde gjatë 2007 se në 2006 dhe shitjet e tyre vazhduan të rriteshin gjatë gjysmës së parë të 2008. DGS ka vazhduar të marrë pjesë në aktivitetet e CEN dhe CENELEC si anëtar i asociuar.

Ligji i ri mbi standardizimin është miratuar në shkurt 2008 dhe legjislacioni përkatës është hartuar. Kjo përfshin edhe krijimin e një bordi mbikëqyrës të përbërë nga përfaqësuesit e aksionarëve të cilët do të monitorojnë aktivitetet e DGS. Në përputhje me ligjin e ri, DGS do të jetë vendi për kërkimin e të dhënave për marrëveshjen mbi barrierat teknike për të bërë tregti sipas rregullave të Organizatës Botërore të Tregtisë (TBT/ËT). Janë duke u kryer përgatitjet në fushën e standardizimit.

Progres i kufizuar është shënuar në vlerësimin e përshtatshmërisë. Numri i organeve të vlerësimit të përshtatshmërisë është rritur lehtë.

Progres i mëtejshëm mund të raportohet në fushën e akreditimit. Një ligj i ri mbi akreditimin u aprovua në Nëntor 2007 dhe zbatimi i legjislacionit është duke u hartuar. Është miratuar strategjia kombëtare mbi akreditimin, e cila është pjesë e strategjisë afat- mesme mbi cilësinë e infrastrukturës.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë të Drejtorisë për Akreditim (DA), është përditësuar për t'u harmonizuar me N ISO/ IEC 17011. U krijuan dy komitete teknike për zhvillimin e skemave të akreditimit në fushat e reja.

Është vënë në punë Organi këshillimor i Akreditimit. DA ka një staf prej 14 vetash dhe është anëtar i Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF), gjithashtu është anëtar i asocuar në Laboratorin Ndërkombëtar për Bashkëpunimin në fushën e Akreditimit (ILAC). Ajo vazhdon të marrë pjesë në aktivitetet e Kooperimit Evropian të Akreditimit. Drejtoria e Akreditimit ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me të gjithë organet e akredituara në vendet fqinje dhe me disa institucione Shqiptare edhe vazhdon të promovojë akreditimin. Përgatitjet në këtë fushë kanë avancuar.

Progres i mirë është arritur në fushën e metrologjisë. Drejtoria e Mbikëqyrjes së Metrologjisë dhe të katër qendrave lokale të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DGM) kanë filluar punën. Trajnime të mëtejshme janë parashikuar të zhvillohen nga stafi i DGM. Sistemi i menaxhimit të cilësisë në përputhje me EN ISO/IEC 17025 është duke u zbatuar nga DGM. Aplikimet për akreditimin në dy laboratorë janë dorëzuar pranë drejtorisë së Akreditimeve në Dhjetor 2007. Disa nga shtatë laboratorët e DGM morën pjesë në studimet midis laboratorëve dhe në trajnime të ndryshme në nivelin dypalësh si dhe në atë rajonal. Strategjia afatmesme mbi zhvillimin e sistemit të metrologjisë u miratua në Dhjetor 2007.

Një ligj i ri mbi transpozimin e dispozitave mbi metrologjinë dhe të direktivave të përafritit të vjetër u miratua në Shkurt 2008. Ky ligj vendos një sistem metrologjie të decentralizuar dhe çliron nga rregullat disa nga aktivitetet e metrologjisë sic janë kalibrimi dhe verifikimi i instrumenteve matëse në përdorim.

Qeveria ka aprovuar rregulloren mbi standardet kombëtare të matjes.

Janë hartuar rregulloret mbi marrëdhëniet midis DGM dhe laboratorëve të tjera. Për të lehtësuar përfshirjen e sektorit privat, DGM ka identifikuar kërkesat e personave juridikë për të punuar në sektorë të ndryshëm të metrologjisë. Gjithashtu DGM ka nënshkruar një marrëveshje njohjeje me Komitetin Ndërkombëtar të Peshave dhe Masave (CIP MRA).

Progres është arritur në mbikëqyrjen e tregut dhe në mbrojtjen e konsumatorëve. Strategjia e re e mbrojtjes së konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut për 2007-2013 u miratua në Nëntor 2007. Ajo është bazuar në tre strategji sektorësh, një mbi prodhimet ushqimore, një mbi produktet farmaceutike dhe një mbi prodhimet industriale. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre strategjive janë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (METE), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MACFCP) dhe Ministria e Shëndetësisë (MoH).

Kapaciteti i Drejtorisë për Mbikëqyrjen e Tregut (MSD) në METE ka ardhur duke u forcuar me shtim personeli me tre punonjës dhe me trajnimin e duhur për legjislacionin horizontal.

Mbikëqyrja aktuale e tregut kryhet nga Inspektorati Qendror Teknik (CTI), që është një Drejtori e Përgjithshme e METE. MSD, dhe CTI dhe autoritetet e doganave i kanë dhënë informacion konsumatorëve mbi rrezikshmërinë e produkteve (p.sh lojërat dhe pajisjet teknike) dhe kanë marrë masa për të tërhequr produkte të tilla nga tregu.

Shqipëria ka bërë një farë progresi në përfarimin e legjislacionit të saj horizontal dhe rregulloret specifike të parashikuara ne acquis. Legjislacioni është amenduar për të mundësuar transpozimin e direktivave mbi lojërat, enët e thjeshta me presion, pajisjeve të voltazhit të ulët

dhe përshatshmërisë elektromagnetike. Gjithsesi, në rastin e direktivave të përafrimit të vjetër progresi i vetëm i arritur, është ai në fushën e metrologjisë.

Është miratuar një ligj mbi mbrojtjen e konsumatorit, i cili ka marrë parasysh standardet relevante të BE. Ligji i ri parashikon një bazë ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke përfshirë Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit si organe konsultative dhe vendimmarrëse. Megjithatë, këto organe nuk janë krijuar ende. Në përgjithësi, përgatitjet në këtë fushë janë në rrugë të mbarë. Sidoqoftë, shumica e acquis që lidhet me këtë sektor duhet të transpozohet dhe zbatohet. Infrastruktura administrative dhe horizontale ekziston, por kapaciteti i autoriteteve dhe institucioneve të ndryshme duhet të përmirësohet më tej.

4.1.2 Lëvizja e Personave, shërbimeve dhe e Drejta e Vendosjes

Ka pasur pak progres në lëvizjen e personave. Ligji mbi të huajt u miratua në Korrik. Përshtatshmëria e tij me standardet relevante të EU , mbetet për t'u parë. Nu ka të dhëna për zhvillime në njohjen e kualifikimeve profesionale ose në koordinimin e sigurimeve shoqërore.

Ka pasur pak progres në të Drejtën e Vendosjes. Qendra Kombëtare e Regjistrimeve për Bizneset ka bërë regjistrimin e bizneseve më të thjeshtë. Tarifat e regjistrimit janë reduktuar dhe licencimi është thjeshtëzuar. (Shih Seksionin 4.2.1 për detaje të tjera). Gjithsesi, pasiguritë mbi të drejtat e pronës vazhdojnë të dekurajojnë vendosjen. Përgatitjet në këtë fushë janë duke avancuar ngadalë.

Ka pasur progres në fushën e së Drejtës për Kompanitë. Një ligj i ri për Shoqëritë tregtare është miratuar në prill 2008. Është hartuar legjislacion implementues, duke krijuar modele për katër lloje të ndryshme të shoqërive tregtare (Shoqëritë Aksionere, ShPK-të, Shoqëritë e Përgjithshme, Shoqëritë e Kufizuara).

Megjithatë, ligji i ri për Shoqëritë tregtare ka mangësi në adresimin e çështjeve që lidhen me shkrirjen e kompanive ndërkufitare dhe për ofertat për blerjen e Shoqërive Tregtare.

Asnjë progres nuk është shënuar në auditim. Çështja e auditimit të bilanceve vjetore nuk është adresuar dhe ka nevojë të krijohet një sistem monitorues.

Pak progres është arritur në fushën e kontabilitetit. Përkthimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS) ka përfunduar, dhe ka hyrë në fuqi në Janar 2008. Shoqëritë me të ardhura vjetore mbi 10 milion € gjatë dy viteve të fundit dhe me mbi 100 ose më shumë punonjës duhet të aplikojnë për IAS.

Agjencia kombëtare e kontabilitetit është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e standardeve të kontabilitetit.

Duhet përpjekje të mëtejshme për të ndërtuar një kuadër financiar raportues funksional , sidomos për ndërmarrjet e vogla ose të mesme. Sigurimi i zbatimit të raportimeve financiare ka nevojë të shtrëngohet më tej.

Ka pasur pak progres për sa i përket lirisë për të ofruar shërbime. Nuk ka pasur një dallim të qartë midis ofrimit të shërbimeve të përkohshme dhe atyre të përhershme.

Qeveria ka nxjerrë vendime mbi licencimet dhe asetet. Për sa i përket shërbimit postar, një draft ka vendosur kufijtë e peshës në zonën e rezervuar si dhe tarifat për ofruesit e shërbimit universal edhe planet qeveritare për liberalizimin e tregut postar të Shqipërisë që nga 2009. Autoriteti rregullues i shërbimeve postare është krijuar pas adoptimit të ligjit mbi komunikimet elektronike në Maj 2008. Sidoqoftë ndarja e funksioneve rregulluese nga politikë-bërja nuk është arritur ende.

Progres i pjesshëm është shënuar në shërbimet financiare. Banka e Shqipërisë ka adoptuar disa rregullore zbatuese që janë marrë nga ligji i Bankave në Qershor 2007.

Rregulloret janë adoptuar mbi menaxhimin e riskut për aktivitete e degëve të bankave të huaja dhe mbi sistem e brendshëm të auditit në degët e bankave të huaja në vend.

Bankat e huaja që operojnë me licence Shqiptare, tani mundet të ofrojnë shërbimet e tyre nëpërmjet degëve duke pasur të drejta të barabarta me bankat Shqiptare.

Ka nevojë për përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit bankar me acquis, veçanërisht në direktivat mbi Kërkesat e Kapitalit.

Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë u përforcua me shtimin e stafit dhe dhënien e trajnimeve për parimet Bazel II, risku i kredive, risku i tregut, menaxhimi i riskut, risku operativ dhe menaxhimi i krizës. Megjithatë, kapacitete të mëtejshme administrative kërkohen për të marrë parasysh zhvillimet në sektorin bankar. Regjistrimi i kredive është vënë në punë, duke forcuar në këtë mënyrë mbikëqyrjen dhe duke përmirësuar menaxhimin e riskut në banka. Bashkëpunimi ndërmjet mbikëqyrësve të autoriteteve kompetente vendase dhe të huaja duhet të forcohet.

Në fushën e sigurimeve nuk mund të raportohet përparim thelbësor. Tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga skemat e detyrueshme të sigurimeve, të cilat zënë dy të tretat e të gjithë sigurimit jo-të jetës. Futja në treg së fundi e tri kompanive të huaja të sigurimeve nuk ka rezultuar në ndonjë shumëllojshmëri të tregut shqiptar. Sigurimi Motorik i palëve-të treta (SMPT) nuk është liberalizuar ende dhe tarifat e kartës së gjelbër vendosen ende nga Ministria e Financave. Ministria vendos gjithashtu tarifa minimale dhe maksimale për SMPT. Kjo kufizon konkurrencën.

Legjislacioni i ri për letrat me vlerë ka hyrë në fuqi duke synuar përafrimin e legjislacionit të Shqipërisë me një numër direktivash si Tregjet në MiFID dhe ato për reklamat, transparencën, transaksionet e fshehta dhe institucionet që lidhen me kreditë.

Tre dekrete të tjera u miratuan në lidhje me ndërmjetësinë e sigurimeve, fondeve të rezervave dhe ekspertëve të sigurimeve për dëmtimet.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) lançoi një sistem të kompjuterizuar për SMPT- i njohur si qendra e të dhënave kombëtare – siç parashikohet sipas Direktivave të Sigurimeve Motorike

të palëve të Katërta dhe të Pesta. Sistemi synon të lehtësojë ndjekjen e automjeteve të palicensuara.

ASHF organizoi seminare dhe sesione trajnimi për çështjet e financimit të sigurimeve dhe pensione. Megjithatë, masa të mëtejshme nevojiten për të forcuar kapacitetet e saj për të përballuar zhvillimet në treg si dhe të garantojë pavarësinë e autoritetit.

ASHF ka të punësuar 45 punonjës, megjithëse lista e miratuar e organizatës ka parashikuar 58. Aktualisht, 90% e buxhetit të përgjithshëm të FSA financohet nga burimet e saj; 10% i mbetur vjen nga buxheti i Shtetit.

4.1.3 Lëvizja e lirë e kapitalit

Nuk raportohet asnjë progres në lëvizjen e lirë të kapitalit. Kuadri ligjor në shkëmbimin e huaj është duke u rishikuar, por procesi ende nuk është përmbushur. Kufizime të rëndësishme ende mbeten deri në liberalizimin e plotë të lëvizjeve të kapitalit të kërkuara sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ka patur disa përmiresime në fushën e sistemeve të pagesave. Banka e Shqiperisë ka lëshuar një projekt elektronik të transmetimit të të dhënave për të përshpejtuar ankandet kryesore tregtare të kursimeve të qeverisë. Numri dhe vlera e transaksioneve dhe pagesave të përpunuara nga sistemi Shqiptar i pagesave ndër-bankare dhe **Albanian electronic clearing house** është rritur. Numri i kartave të kreditit dhe debitit në përdorim, gjithashtu është rritur dhe rrjeti i stacioneve fundore që përdorin ato është zgjeruar. Megjithatë, Shqipëria vazhdon të mbetet një ekonomi e predominuar nga pagesat në dorë (cash). Shkalla e ndërhyrjes financiare vazhdon të mbetet relativisht e ulët.

Përgatitjet në fushën e levizjes së lirë të kapitalit dhe sistemet e pagesave mbeten në një fazë fillestare.

4.1.4 Doganat dhe tatimet

Janë bërë disa përparime në fushën e **doganave**. Shqipëria ka marrë masa për të siguruar implementimin në kohë të reduktimit të tarifës së parashikuar në Marrëveshjen e Përkohshme. Priorja në rritje në mbledhjen e të ardhurave ka vazhduar, pavarësisht reduktimit të nivelit mesatar të tarifave të doganave. Mbledhja e detyrimeve doganore gjatë periudhës nga Tetor 2007 ne Maj 2008 tejkaloi shumën e planifikuar prej 6%.

Kompjuterizimi i qendrave doganore është përmbushur dhe të gjitha deklaratimet doganore kanë ecur duke përdorur sistemin kompjuterik ASYCUDA++. Shpërngulja në sistemin ASYCUDA Ëord është në progres. Megjithatë, përpjekje kërkohen për të përcaktuar një strategji IT afatgjate.

Përdorimi i moduleve të kompjuterizuara të analizës së riskut është zgjeruar, por përqindja e inspektimit fizik (20-25%) është ende e lartë nga standartet Europiane. Llogaritja e riskut dhe kontrollet nevojitet të korrigjohen dhe forcohen duke përfshirë për diskutim vlerën e deklaruar të transaksionit. Shqipëria ka implementuar konventën TIR dhe procedurat. Janë ndërmarrë

hapa për krijimin e zonës së parë Shqiptare të lirë në portin e Durrësit. Janë autorizuar 38 godina doganore në 2008.

Nomenklatura e Bashkuar 2008 për klasifikimin e mallrave në treg me BE është miratuar. Koncepti informacionit të origjinës së detyrueshme u prezantua në Maj 2008. Dispozita të reja janë prezantuar gjithashtu në rolin e doganave në mbrojtjen e të drejtave të pronësive intelektuale të parashikuara për përafrimin në standartet Europiane. Kontrolli i përdorimit të dyfishtë të mallrave është implementuar në sistemin e menaxhimit të riskut. Megjithatë, nuk mund të raportohet progres në kontrollin efektiv të të drejtave të pronësive intelektuale nga autoritetet doganore.

Nevojitet progres i metejshëm në përafrimin me praktikën e BE, në veçanti në procedurat e thjeshtuara, rregullat e origjinës, metodat e vlerësimit (përdorim më i mirë i vlerës së transaksionit) dhe transit (Konventa ATA). Është bërë një studim i impaktit ekonomik e procedurës **carnet** të ATA. Një marrëveshje nevojitet të nënshkruhet ndërmjet doganave dhe një shoqërie kombëtare garante. Nevojitet të vendoset pajtimi me Marrëveshjen e Perkohshme të regjimit Shqiptar të taksave, për makinat e importuara.

Lidhur me aftësitë operative dhe administrative, legjislacioni u miratua në korrik 2008, duke rritur stafin e administratës së doganave me 27 vende. Procedura për krijimin e një grupi të kualifikuar trenerësh ka filluar dhe aktivitetet trajnuese janë organizuar në çështjet doganore dhe tarifore, marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe procedurave TIR. Megjithatë, ende nuk është krijuar një strategji për trainimin. Është përcaktuar një interpretim i ri në sistemin tregues për të lehtësuar zhvillimin profesional. Megjithatë, sistemi lejon vetëm vlerësim individual. Zyrtarët doganorë ende nuk kanë status të nepunës civil.

Përsa i takon zhvillimit infrastrukturor, puna ka filluar mbi një projekt për të përmirësuar me tepër infrastrukturën e kategorisë së parë, të dytë dhe të tretë të pikave të kalimit ndërkufitar (PKN). Po krijohet një pikë e përbashkët kalimi ndërkufitar me Malin e Zi dhe janë lançuar procedurat për ndërtimin e 10 pikave të tjera të vogla të kalimit ndërkufitar. Infrastruktura e godinave të doganës së Tiranës është duke u përmirësuar.

Në tërësi, përgatitjet në fushën e doganave po avancohen, por nevojiten përpjekje të metejshme në përafrimin ligjor dhe implementimin e legjislacionit.

Ka patur progres në fushën e **taksave**. Ligji mbi procedurat për administrimin e taksave është miratuar me synimin e zvogelimit të ekonomisë informale dhe përmirësimin e atmosferës së biznesit. Dispozita që kërkon pagimin e taksës së plotë të caktuar plus gjobe 15% përpara dorëzimit të një apelimi gjyqësor kundrejt vendimeve të administratës tatimore është shfuqizuar. Sistemi i taksave po bëhet më i thjeshtë, si përafësisht 95% e taksapaguesve janë subjekt i taksës së sheshtë 10% mbi të ardhurat. Reforma e taksave ka treguar një tendencë pozitive drejt rritjes së mbledhjes së taksave, veçanërisht tatimit mbi të ardhurat dhe tatimit mbi fitimin. Shqipëria ka filluar një vlerësim të përafrimit të legjislacionit të saj të taksave me Kodin e Sjelljes mbi taksimin e biznesit të BE.

Kompjuterizimi i zyrave të taksave është duke përpëruar dhe 90% e të gjithë taksapaguesve tashmë janë regjistruar në sistemin e integruar të taksave. Procedurat E-taksa (sistemi elektronik) po implementohen dhe janë duke u përdorur nga taksapaguesit për të regjistruar

kompensimet e tyre dhe të paguajne taksat e tyre. Drejtoria për Regjistrimin dhe Sherbimet e Taksapaguesve u fut në veprim për të siguruar mbështetje për çështjet e taksave. Është hartuar një manual për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në administrimin e taksave dhe është siguruar për stafin e administrimit të taksave trajnim mbi kontrollin e taksave dhe çështjet e auditit. Janë marrë masa disiplinore kundrejt stafit që ka deshtuar në përmbushjen e detyrave të tyre.

Megjithatë, shkalla e mbledhjes së taksave mbetet e ulët, vecanërisht nga qeverisja lokale. Ekziston nevoja për rritjen e kapaciteteve të zyrave të taksave të qeverise lokale, vecanerisht në kuadrin e decentralizimit fiskal. Një mbledhje gjithëpërfshirëse e taksave dhe strategjia kontrollit ende nuk është zhvilluar dhe ekonomia informale është e larte. Këshillimi me komunitetin e biznesit nevojitet të rritet për të larguar pasigurinë rreth ambjentit legjislativ dhe të lehtësojë implementimin e reformave të taksave. Përshtatja e disa ndryshimeve të përqindjeve të TVSH-se për materialet e importuara të stampuara me detyrimet e Shqiperise sipas Marrëveshjes së Perkohshme nevojitet të vleresohet. Nevojitet të krijohet përshtatja me standartet Europiane në rastin e amendamenteve të ligjeve për akcizen në lidhje me perkufizimin e prodhuesve të vegjel të veres dhe disa ceshtje të rimbursimit të akcizes së karburanteve.

Në tërësi, përgatitjet në fushën e taksave po avancojnë disi. Nevojiten përpjekje për të përafuar legjislacionin Shqiptar me *acquis*, për të siguruar përputhmërinë me Marrëveshjen e Perkohshme dhe perforcjë kapacitetin administrativ për të ndaluar ekonominë informale dhe ulë evazionin e taksave.

4.1.5. Konkurrenca

Progresi ka vazhduar në fushën anti-monopol. Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (AShK) ka rekrutuar staf shtesë dhe ka plotësuar 35 vendet e tij. Stafi i ASHK ka marre pjese në seminare trajnuese në Shqipëri dhe jashtë. Kodi i etikës i Autoritetit të Konkurrencës është miratuar dhe parlamenti ka miratuar strukturën dhe tabelën e organizimit të autoritetit në Maj 2008.

ASHK ka kontribuar në promovimin e kulturës së konkurrencës duke organizuar mbledhje pune, krijuar dokumenta të politikës konkurruese dhe duke nënshkruar memorandume mirëkuptimi me autoritete të ndryshme rregulluese. Këto përfshijnë Bankën e Shqipërise, Ministrinë e Energjise, Tregtise dhe Energjise, Entin Rregullator të Telekomunkacioneve, Shoqatën për Mbrojtjen e Konsumatoreve, Drejtorinë e Pergjithshme të Konsumatoreve dhe Agjensinë e Prokurimit Publik. Kultura e konkurrencës në Shqipëri po zhvillohet ngadalë. Bizneset kanë filluar të paraqesin pakenaqësitë rreth praktikave anti-konkurruese. Kjo tregon për rritjen e kujdesit publik për të mirat e detyrimeve të konkurrencës.

ASHK ka imponuar gjobë prej 2 % të xhiros totale për dy shoqërite e telefonisë celulare për abuzimin me pozicionin e tyre sundues në treg. Ende nuk është marrë një vendim gjyqësor për apelimin e bërë nga dy shoqëritë. ASHK gjithashtu ka vendosur gjoba për prodhuesit e bukës dhe përpunuesit e cimentos për shkeljen e rregullave të konkurrencës. ASHK ka lëshuar rekomandime për tregun e telekomunikacionit. Ka vazhduar investigimet në tregun e sigurimeve, vendosi investigim sektorial në tregun e energjisë dhe filloi analizimin e sektorit bankar. Ai gjithashtu vlerësoi disa njoftime bashkimi. Ligji mbi konkurrencën është në masë të

gjerë në linjë me *acquis*. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për miratimin e legjislacionit implementues në fushën e konkurrencës.

Ka patur progres në fushën e **ndihmës Shtetërore**. Kuadri ligjor dhe Institucional është forcuar nga miratimi i rregullave implementuese në ndihmën horizontale dhe direktivave për ndihmën në formën e kompensimit për shërbimet publike. Stafi i Departamentit të Ndiemes Shtetërore (DNSH) ka vazhduar të marrë trajnime, duke përfshirë ndihmën në sektorin e shërbimeve. DNSH ka siguruar këshilla mbi disa drafte legjislative dhe ka vazhduar të rrisë informimin e përfituesve të shërbimit Shtetëror. Në Janar 2008 është miratuar raporti mbi inventarin e skemave ekzistuese të ndihmes, dhe raporti vjetor mbi ndihmën Shtetërore për 2007 është miratuar në Korrik 2008. Komisioni për Ndihmën Shtetërore mori tetë vendime për çështjet e njoftuara nga përfituesit e ndihmës. Shqipëria ka filluar përgatitjet për implementimin e dispozitave për ndihmën Shtetërore, në protokollin e hekurit dhe celikut të Marrëveshjes së Perkohshme. Megjithatë, ende nuk është marre vendim për pranimin e ndihmës Shtetërore për sektorin e hekurit dhe celikut. Nevojitet të bëhen përpjekje përsa i përket implementimit.

Në tërësi, përgatitjet në fushën e konkurrencës janë në rrugën e duhur.

4.1.6. Prokurimi Publik

Ka patur progres të kufizuar në fushën e prokurimit publik. Kuadri ligjor i sistemit të prokurimit publik nuk ka ndryshuar në mënyrë thelbësore. Amendamenti i parë rishikon pjesërisht dispozitat mbi përdorimin e procedurave të diskutimit në raste të urgjences ekstreme. I dyti i përket shit-blerjes së energjisë. Lejon prodhimin e energjisë në vend dhe paraqet dispozita të reja duke lejuar përdorimin e procedurave të diskutimit pa publikim të mëparshëm të njoftimit të kontratës. Ai gjithashtu lejon përdorimin e kuadrit të marrëveshjeve për shit-blerjen e energjisë. Ky amendament nuk është në linjë të plotë me dispozitat perkatëse të direktivave të prokurimit të KE.

Kapaciteti i Agjensise të Prokurimit Publik (APP) është forcuar nga rekrutimi i 10 punonjësve shtesë. APP-ja ka vazhduar të organizojë seminare trajnime mbi prokurimin publik. Megjithatë, autoritetet kontraktuese ende kërkojnë më në thelleshi trajnime praktike për të forcuar kapacitetin e tyre operativ dhe profesional. Roli i APP si autoriteti qendror kordinues dhe keshillues për reformat ligjore dhe procedurale ka nevojë për forcime të mëtejshme për të siguruar zhvillim të qendrueshëm në të gjitha fushat e prokurimit publik. Aktivitetet legjislative në disa fusha të prokurimit publik ende janë të ndara midis aksionereve të ndryshëm.

Avokati i Prokurimit Publik është krijuar si një institucion i pavarur duke i raportuar parlamentit. Megjithatë, nuk ka kompetenca të vecanta ekzekutive dhe funksionet e tij publikojnë detyrimet e APP. Kuadri institucional për kompensimet nuk është në linjë me *acquis*. Vendimet mbi apelimet janë marrë nga e njëjta njësi e APP që është përgjegjëse për interpretimin e ligjit dhe dhënien e këshillave për autoritetet kontraktuese.

Procedurat aktuale për trajtimin e ankesave ende nuk i plotësojnë standartet ndërkombetare.

Shqipëria ka prezantuar prokurimin publik elektronik në fund të 2007. Tashmë po përdoret nga të gjitha ministritë dhe gjithashtu nga Korporata Energjitike dhe Drejtoria e Përgjithshme e

Rrugëve. Megjithatë, aplikimi i tij është vështirësuar nga probleme teknike dhe pamjaftueshmëria e kapaciteteve të IT e autoriteteve kontraktuese.

Në tërësi, përgatitjet në fushën e prokurimit publik kanë avancuar. Megjithatë, nuk ka koherencë, strategji gjithëpërfshirëse për zhvillim të metejshëm të sistemit të prokurimit afat mesëm dhe afat gjatë. Përafrim i mëtejshëm kërkohet në të gjithë fushat e prokurimit publik, vecanërisht për koncensione dhe sherbime.

4.1.7. Ligji për Pronësinë Intelektuale

Ka patur progres të kufizuar mbi të drejtat e pronësisë intelektuale. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Autoritetin e Konkurrencës, Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe administrata e taksave dhe doganave, me qëllimin e luftimit të piraterisë dhe forcimin e ligjit për të drejtën e autorit. Janë ndërmarrë inspektive të përbashkëta me administratën e taksave në qytete të ndryshme, dhe janë vendosur gjoba administrative për shkelset e të drejtës së autorit. Megjithatë, numri i rasteve të dhunimit të ligjit për të drejtën e autorit të cuara në gjykatë, është i ulët. Amendamentet e dispozitave që implementojnë Kodin e Doganave në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe kontrollit të markave janë miratuar në mënyrë që të lejojë produktet të klasifikohen si “fallco”, “te piratuara” ose “pergjegjes për shkeljen e të drejtave të mbajtesve të patentës ose certifikave”. Strategjia e planit kombëtar mbi kulturën kryesisht adreson çështje në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së autorit. Megjithatë, strategjia kombëtare mbi të drejtat e pronësisë intelektuale nuk është përgatitur ende.

Disa fushata informimi mbi të drejtat e pronësisë intelektuale janë organizuar dhe stafi i ZSHDA ka bërë trajnime specifike mbi të drejtën e autorit dhe çështjet e detyrueshme ligjore. Megjithatë kapaciteti i ZSHDA nevojitet të forcohet nëpërmjet trajnimeve të metejshme dhe burimeve njerezore shtese. Aktualisht, supozohet se një inspektor për të drejtën e autorit do të mbulojë të gjithë vendin. Ekzistojnë plane për zyra rajonale për të drejtën e autorit, por keto ende nuk janë krijuar.

Ka patur progres përse i përket të drejtave të pronësisë industriale. Një Ligj i ri mbi të drejtat e pronësisë industriale është miratuar në Korrik të 2008. Legjislacioni i tij implementues është ende duke u përgatitur. Është krijuar një Bord Apelimi në Drejtorinë e Patentave dhe Markave (DPM) dhe Drejtoria permbushi riorganizimin e sistemit të tij kompjuterik. DPM ka organizuar seminare trajnues dhe aktivitete për të promovuar vlerat e të drejtave të pronësisë industriale, dhe Zyra Europiane e Patentës (ZEP) ka siguruar asistencë për DPM dhe ZSHDA. Është publikuar buletini i të drejtave të pronësisë industriale i cili përmban shënime të regjistrimeve dhe ndryshime të titujve të të drejtave të pronësisë industriale dhe versioni on-line është i përdorshëm në adresën e internetit të DPM. Këshilli Administrativ i ZEP miratoi kërkesën e Shqiperisë për hyrje në Konventën Europiane të Patentave. Përgatitjet për ratifikimin e saj janë në proces.

Kapaciteti i ZSHDA dhe DPM kërkojnë forcime të metejshme. Pirateria dhe falsifikimi mbeten të përhapura. Forcimi vështirohet nga pamjaftueshmëria e kapacitetit inspektues dhe niveli i ulët i gjobave sipas legjislacionit aktual, plus mungesa e kujdesit të duhur, eksperiencës dhe kualifikimit në këtë fushë nga ana e gjykatave. Numri i çështjeve në lidhje me dhunimin e të drejtave të pronësisë industriale që janë dërguar në gjykatë mbetet ende mjaft i ulët. Përpjekje

të mëtejshme nevojitet të përmirësojnë bashkëpunimin ndër-institucional dhe aftësinë e autoriteteve doganore për dallimin e produkteve të falsifikuara. Niveli i përgjithshëm i kujdesit mbi të drejtat e pronësisë industriale dhe të mirat e tyre është ende i ulët.

Në tërësi, përgatitjet në fushat e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale nuk janë shumë të avancuara.

4.1.8. Punësimi dhe politikat sociale

Ka patur progres në fushën e **politikave të punësimit**. Strategjia e Trajnimit për Punësim dhe Profesionalizëm për 2008-2013 është miratuar. Synimi i saj kryesor është ulja e nivelit të papunesisë në nivel të krahasueshëm me vendet e BE në 2013. Janë miratuar programet e reja për promovimin e punësimit, duke siguruar **subvencionimin e** punonjësve për trajnim dhe/ose duke punësuar personat e papunë. Një prej programeve ka objekt vecanërisht gratë e papuna. Masat për promovimin e punësimit të të diplomuarve të rinj, janë intensifikuar. Megjithatë, monitorimi dhe vlerësimi i impaktit të këtyre programeve kanë ende mungesa.

Pagat dhe pensionet minimale vazhdojnë të rriten dhe legjislacioni që rrit nivelin baze të përfitimeve të papunësisë është aprovuar. Sistemi i informacionit elektronik është duke u zhvilluar në zyrën qendrore të shërbimit kombëtar të punësimit dhe në dy zyra rajonale. Është krijuar baza e të dhënave mbi vendet e lira të punës, kërkuesve të punës dhe aktivitetet trajnuese. Megjithatë, sistemi ende nuk është shtrirë në të gjitha zyrat. Në përgjithësi, lidhja ndërmjet trajnimeve profesionale të ofruara dhe kërkesave të tregut të punës nuk është e mjaftueshme, dhe kapaciteti i zyrave të punës për të perballuar studimet e tregut të punës nuk është sa duhet i forte. Gjithashtu kapaciteti i zyrave rajonale të punës mbetet i kufizuar.

Ne fushën e politikave sociale, përgatitjet për amendamentin e ligjit për punësimin janë në proces.

Përsa i përket shëndetit dhe sigurisë në punë, është bërë progres në fushën legjislative. Në Mars 2008 Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për përcaktimin e substancave të rrezikshme. Është ngritur një grup pune për të përgatitur strategjinë kombëtare për shëndetin dhe sigurinë në punë. Stafii i Inspektoriatit Shtetëror të Punës është rritur nga 130 në 167 dhe 12 drejtori rajonale janë krijuar tashmë, megjithëse kanë mjaft mungesa të burimeve fizike. Drejtoria për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë është riorganizuar dhe forcuar, por nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për të caktuar të drejtat në punë dhe burimet e saj teknike janë të varfra. Incidenti i Gerdecit në Mars 2008 tregoi mungesa në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe nevojën për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet inspektoriatit të punës dhe administratës së punës.

Dialogu social është ende në shkallë zhvillimi, dhe pozita e bashkimeve tregtare dhe organizatave të punonjësve mbeten njësoj të dobëta. *(Shih gjithashtu seksionin politik-te drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.)*

Strategjia për *mbrojtjen sociale dhe perfshirjen sociale* për 2008-2013 është miratuar. Ajo kërkon reformimin e skemës së asistencës ekonomike për familjet e varfëra dhe pagesat në dorë për grupet në nevojë, duke ngritur komunitete të shërbimeve sociale, mbrojtjen e fëmijëve dhe duke siguruar përfshirje sociale të minoriteteve, të paafet dhe të moshuarit. Buxheti i 2008

siguron 1.3% të produktit të brendshëm bruto (PBB) për mbështetjen e të varfërve dhe vulnerabëlve. Përmirësimet në metodën e përcaktimit të numrit të familjeve të varfra kanë rezultuar tashme në rritje të mbështetjes ekonomike të siguruar. Strategjia gjithashtu siguron decentralizimin e shërbimeve në qeverisjen lokale. 43 shërbime për komunitetet dhe 29 shërbime rezidenciale për të paaftët dhe të moshuarit janë aplikuar gjatë 2007. Inspektoriat i Shërbimeve Sociale është ngritur për të mbikqyrur në nivele qendrore dhe lokale, implementimin e standarteve të aplikueshme për shërbimet e kujdesit social. Megjithatë analizat e përjashtimit social dhe varfërisë nuk janë zhvilluar mjaftueshëm, duke përfshirë bashkëpunimin për monitorimin e varfërisë. *(Shih gjithashtu kriterin politik-te drejtat ekonomike dhe sociale.)*

Janë bërë përpjekje për përmirësimin e pashkëputur financiar të skemës së sigurimeve shoqërore. Janë përmirësuar procedurat për pensionet dhe sigurimet shoqërore. Puna ka filluar me arkivën qendrore dixhitale për sigurimet shoqërore që do të lejojë regjistrimin elektronik të llogarive individuale të kontribuesve dhe pagesat e perfitimeve.

Në tërësi, përgatitjet në fushat e punësimit dhe politikave sociale po avancojnë në mënyrë mesatare. *(Shih gjithashtu seksionin për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve për përfshirjen sociale, anti-diskriminimi dhe shanset e barabarta.)*

Ka patur progres në fushën e politikave të shëndetit publik. Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim përfshin një numër të aktiviteteve për shëndetin publik. Shqipëria ka përafruar një pjesë të kuadrit ligjor me standartet e BE duke miratuar ligje për transfuzionin e gjakut. Është përgatitur një plan trajnimi për mësuesit e shkollave dhe janë ngritur strukturat për kontrollin e duhanit. Megjithatë, implementimi i legjisllacionit të ri për transfuzionin e gjakut është ende duke u diskutuar dhe implementimi i Ligjit për mbrojtjen e shëndetit kundër produkteve të duhanit është përgjithësisht i varfër. Ligji për kujdesin shëndetësor ende nuk është miratuar. Në tërësi, kapaciteti administrativ në fushën e shëndetit publik mbetet i dobët dhe pabarazia vazhdon në zonat rurale. Përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të avancuara. *(Shih gjithashtu seksionin politik mbi shëndetin mendor.)*

4.1.9. Arsimit dhe kërkimi

Mund të raportohet progres në fushën e arsimit. Buxheti për arsimin në 2008 është rritur me 12% në krahasim me vitin e mëparshëm. Sipas planeve, kjo prirje do të vazhdojë në periudhën 2009-2011. Pagat për mësuesit para-universitar janë ngritur dhe rritje të mëtejshme të pagave të mësuesve janë planifikuar për vitin e ardhshëm.

Këshilli Kombëtar i Arsimit Para-Universitar është ngritur, duke përfshirë ekspertë dhe perfaqësues të pavarur nga administrata kombëtare dhe lokale. Ai synon dhënien e këshillimit për programet kombëtare dhe strategjitë, reformat curriculat, buxhetet dhe standartet vlerësuese. Implementimi i skemes për provimet përfundimtare dhe pranueset për universitetet (“Matura Shtetërore”) po vazhdon dhe skema për pjesëmarrjen e studenteve me paaftësi po thjeshtohet. Një sistem qendror dixhital për pranimet në universitete është krijuar dhe është prezantuar këshillimi për karrierën për aplikantët e arsimit të lartë. Kanë filluar programet për zhvillimin e kualifikimeve profesionale për mësuesit. Është miratuar legjisllacioni për liberalizimin e tregut të teksteve shkollë. Është prezantuar skema për subvencionimin e blerjes

se teksteve shkollore për studentet që vijnë nga familje vulnerabel dhe familje që marrin ndihmë sociale.

Ka nisur puna për zhvillimin e kuadrit të kualifikimeve. Parlamenti ka miratuar nje shtesë për kohëzgjatjen e arsimit të detyrueshem nga tete në nëntë vjet. Një plan master është përgatitur për implementimin e një programi “e-school” për të rritur teknologjitë e informacionit në shkolla. Qeveria po ndërmerr masa për rritjen e rregjistrimit në arsimin e mesëm. Gjithashtu janë bërë përpjekje për të bërë arsimin profesional dhe trajnimet “VET” më tërheqës dhe të përfshijë punonjës potencialë në përgatitjen e programeve. Një financim i vecantë është dhënë për 25 studente në 2007.

Megjithatë, regjistrimi në arsimin e mesëm në zonat rurale mbetet akoma mbrapa. Përpjekje të vazhdueshme kërkohen për trajnimet profesionale. Infrastruktura e varfër e arsimit profesional po pengon zhvillimin e këtij sektori. Përpjekje nevojiten për të konsoliduar dhe shtrirë rrjetin e qendrave të arsimit profesional dhe për të nxitur lidhje më të aferta midis arsimit dhe tregut të punës.

Zyra Kombëtare Tempus (ZKT) ka përmirësuar kapacitetin monitorues dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencave. Megjithatë nga NATO kërkohen përpjekje të mëtejshme për të rritur pjesëmarrjen në program duke përmirësuar cilesinë e projekteve të paraqitura nga Universitetet Shqiptare. Përgatitjet në fushën e arsimit po avancojnë në mënyrë të moderuar.

Ka patur progres në fushën e kërkimeve. Që nga Janari 2008, Shqipëria merr pjesë në Programin e Shtatë kuadër të KE për kërkimet dhe zhvillimin teknologjik (FP7) si një shtet i asociuar dhe ka marrë masa për të rritur pjesëmarrjen në FP7. Megjithatë pjesëmarrja e sukseshme nga Shqipëria në FP7 do të kërkojë forcimin e kapaciteteve administrative dhe kombëtare të kërkimeve, duke përfshirë investime në infrastrukturën e kërkimeve dhe nxitje për të tërhequr studentët në shkencë. Kërkohen gjithashtu përpjekje për të rritur bashkëpunimin me partnerët e tjerë ndërkombëtarë.

Është miratuar nje plan afat-mesem buxhetor për kërkime shkencore për periudhën 2009-2011, duke shënuar rritje vjetore 35% të buxhetit kombëtar për kërkime. Buxheti për kërkime dhe zhvillim u dyfishua në 2008. Megjithatë, pjesa e tij nga buxheti i plotë (0.16%) është ende mjaft e ulët.

Shqipëria ka filluar të riprojektojë politikat e saj kërkuese. Ka marrë drejtim përmirësimi i lidhjeve ndërmjet insituteve të kërkimit dhe universiteteve. Programet “Fundex” dhe “Brain Gain” janë lancuar me qëllim inkurajimin e kërkuesve të rinj shqiptarë që punojnë jashtë që të kthehen. Po merret në konsideratë themelimi i një qendre për promovimin dhe implementimin e programeve për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kombëtar në kërkime. Rrjeti kombëtar **Euraxess mobility portal and netëork** nevojitet të integrohet me shërbimin European Euraxess.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e kërkimit po avancojnë në mënyrë të moderuar.

4.1.10 Cështjet e OBT

Shqipëria po vazhdon të implementojë detyrimet e saj ndaj OBT. Drejtoria për Politikën e Tregtisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës vepron si sekretariat për çështjet e OBT përmes sektorit të tij për marrëdhëniet me OBT dhe bashkëpunimin ekonomik. Shqipëria po punon për identifikimin e nevojave trajnuese për të rritur kapacitetin e politik-berjes në fushën e tregtisë. OBT përfundoi me sukses vlerësimin e Marreveshjes së Përkohshme BE-Shqipëri. Shqipëria mori pjesë në mënyrë aktive në këtë proces.

4.2 Politikat Sektoriale

4.2.1 Industria dhe SMEtë

Ka patur progres në fushën e industrisë dhe SMEve. Që në Janar 2008, Shqipëria është duke marrë pjesë në programin komunitar sipërmarrje dhe novacion. Ka patur progres në implementimin e Aktit Europian për sipërmarrjet e vogla. Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit (QKR) mund të regjistrojë një biznes të ri brenda një dite të vetme. Numri i hapave që kërkohen për regjistrimin e biznesit është ulur dhe kostot e regjistrimit janë tashmë afërsisht 1 Euro. QKR ka rritur stafin e tij dhe ka 19 dritare operative në rrethe të ndryshme. Ka plan që të hapen 12 dritare shtesë dhe të rritet bashkëpunimi ndërmjet QKR dhe dhomave të tregtisë dhe industrisë. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të forcuar kapacitetet në degët e QKR në qytete.

Procedurat e licensimit janë rishikuar dhe thjeshtuar. Kërkesat e licensimit janë reduktuar. 64 nga 151 licenca të identifikuar në 18 sektore të ekonomisë u hoqën dhe 21 të tjera u ndryshuan nëpërmjet vetëdeklarimit. Puna është në progress për të identifikuar licenca të tjera të cilat mund të hiqen. Megjithatë, licensimi dhe proceset e pas-rregjistrimit kërkojnë thjeshtim të mëtejshëm dhe heqja e licencave kërkohej që të shoqërohet nga një forcim i mbikqyrjes (kontrollit) të kapaciteteve të agjensive publike në mënyrë që të garantojë standardet të cilat ruajnë të drejtat e konsumatorëve.

Një regjistër online është krijuar, ligji për firmosjen elektronike është aprovuar dhe ka filluar implementimi i ligjit për prokurimin elektronik. Barra fiskale mbi ndërmarjet u ul në Janar 2008 nga ulja e taksës së fitimit nga 20% në 10%. Bizneset mund të skedojnë kthimet e taksave dhe deklarimet e kontributeve sociale elektronikisht në 12 qytete përfshirë Tiranën. Pagesa elektronike e taksave është gjithashtu e mundur nëpërmjet disa bankave. Një ligj i ri për kompanitë u miratua në prill 2008 duke ndjekur miratimin e strategjisë së re të SME në 2007. Ligji i falimentimit u miratua, duke siguruar një strukturë më efektive për daljen nga tregu. Ligji mbi Dhomat e tregtisë dhe industrisë u ndryshua për të hequr kërkesat e detyrueshme për kompanitë për t'u regjistruar në Dhome. Mbledhja Këshillimore e Biznesit ka qenë aktive në përfaqësimin e interesave të bizneseve. Megjithatë, pjesëmarrja nga bizneset dhe shoqatat e tyre në procese legislative mund të rritet.

Qeveria aprovoi krijimin e 6 parqeve industriale. Përveç kësaj, fondi i konkurrencës dhe fondi i garantimit të kredive të eksportit po implementohen. Ligji mbi mashtrimin është ndryshuar. Në Qershor 2008 qeveria aprovoi kuadrin rregullator për implementimin e një kredie 30 milion

euro, rënë dakord midis Shqipërisë dhe Italisë. Zyra e Menaxhimit të Projektit është krijuar. Megjithatë, përpjekje të tjera kërkohen në mënyrë që të përmirësohet konkurrenca e sektorit të SME.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar mjedisin e biznesit. Kuadri rregullator tani është më i përshtatshëm për të zhvilluar një biznes. Megjithatë, përpjekje të tjera janë të nevojshme për zbatimin e kontratave dhe të drejtat e pronës, ashtu si edhe në efektivitetin dhe transparencën e mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve. Përgatitjet në fushën e industrisë dhe SME po përparojnë.

4.2.2. Bujqësia dhe peshkimi

Progres është bërë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Legjislacioni i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u miratua, duke siguruar bazat ligjore për politikën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Qeveria miratoi Strategjinë për bujqësinë dhe Sektorin e ushqimit dhe Strategjinë e Zhvillimit Rural për periudhën 2007-2013. Një ligj i ri për ushqimin u miratua i cili siguroi mbështetje për udhëzimet gjeografike dhe për origjinën e produkteve të etiketuara. Megjithatë, ky ligj sidoqoftë duhet të implementohet. Mbështetja direkte e fermerëve vazhdoi dhe u zgjerua më tej me qëllimin për të inkurajuar prodhimin dhe konsolidimin e fermave tregtare. Ajo është drejtuar ndaj plantacioneve të frutave, pemeve të ullirit dhe vreshtave, fermave të gjese se gjalle, prodhimit të serrave, dhe ujitjes. Buxheti për vitin 2008 është rreth 7 milion euro.

Shërbimet e zgjerimit u fuqizuan. Qendrat e Informacionit të bujqësisë morën pajisje dhe rritën aktivitetet e publikimit dhe prezencën e medias. Bashkëpunimi me Qendrat e Transferimit të Teknologjisë së Bujqësisë kanë rezultuar në 25 projekte kërkimore të fermave duke përfshirë një numër të madh të fermave, dhe në një masë të madhe aktivitetesh trajnimi. Bujqësia organike ishte një pjesë e rëndësishme e programeve të zgjerimit.

Në fushën e zhvillimit rural, autoriteti menaxhues përgjegjës për programimin e masave mbështetëse për zhvillimin rural dhe për drejtimin e monitorimin dhe procesin e raportimit u ngrit. Një studim mbi fillimin dhe funksionimin e një agjencie pagesash të parashikuar nga Legjislacioni për bujqësinë dhe zhvillimin rural përfundoi. Agjencia është gati për të filluar punën në vitin 2009.

Megjithatë, dobësia e strukturave si ndarja e tokave, sisteme të dobëta marketimi dhe niveli i ulët i edukimit teknik të punëtorëve të kualifikuar në ferma akoma godet sektorin konkurrues dhe kapacitetin e tij për të arritur kërkesat e produkteve ushqimore. Prodhimi bujqësor vazhdoi të rritet në një masë të vogël krahasuar me ekonominë në tërësi, dhe deficiti i tregtisë në bujqësi dhe në produktet e përpunuara bujqësore vazhdoi të rritet. Shqipëria nuk përmbush kërkesat e veta as me produktet tradicionale si qumështi dhe produktet e perditshme, zarzavatet dhe mishin.

Në fushën e sigurisë së artikujve ushqimorë, veterinarisë dhe politikave fitosanitare progresi ka qenë i kufizuar. Ligji i ri mbi artikujt ushqimorë i miratuar në Janar 2008 përcakton parimet kryesore për artikujt ushqimorë dhe higjienën e ushqimit. Miratimi i akteve nënligjore ka filluar. Qeveria ka aprovuar një numër rregullash për kontrollin e sëmundjeve të kafshëve; megjithatë, ato nuk janë në pajtim të plotë me legjislacionin e BE. Buxheti i Shtetit mbështet masat profilaktike kundër brucelozës, tuberkulozit, antraksit dhe etheve të derrave. Qeveria ka marrë

masa për t'i dhene shtysë regjistrimit të ripërtpësve. Fondet janë caktuar për regjistrimin e gjedhit në fund të vitit 2008. Megjithatë, implementimi i regjistrimit është shtyre dhe vetem 40-45% e objektivit të tij është arritur në fund të shtatorit 2008.

Asnjë progres nuk mund të raportohet përsa i perket përmirësimit të ndërmarrjeve agro-ushqimore.

Sistemi i kontrollit të molusqeve të gjalla akoma nuk mund të konsiderohet që të jetë ekuivalent me sistemin e Komunitetit. Garanci specifike lidhur me histaminën ende kërkohen për cdo ngarkesë të peshkuar dhe produkteve të peshkut të caktuara për tregtinë me BE. Shqipëria po zhvillon kapacitetet e saj për testimin e histaminës. Megjithatë, progres i mëtëjshëm për përmirësimin dhe akreditimin e laboratorëve është ende i nevojshëm.

Ka patur progres të kufizuar në sektorin fitosanitar. Janë miratuar ndryshime në Ligjin mbi Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve dhe në normat mbi regjistrimin dhe vendosjen në treg të produkteve të mbrojtjes së bimëve. Kapaciteti i pikave të Inspektimit të Kufirit në veterinarin dhe në sektorët fitosanitarë **është** fuqizuar duke hartuar legjislacionin të ri dhe nga furnizimi me pajisje si dhe trajnimit.

Përvec kësaj, është bërë progres në përmirësimin e strukturës ligjore të bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë së artikujve ushqimorë, veterinarisë dhe politikave fitosanitare, por përpjekje të mëtëjshme ende kërkohen në mënyrë që të rrisin kapacitetin e të gjithë aktorëve të përfshirë. Përgatitjet në këtë fushë po avancojnë në mënyrë të moderuar.

Ka pasur progres në fushën e peshkimit në lidhje me inspektimin, kontrollin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Shqipëria u bë anëtare e Komisionit Evropian për Mbrojtjen e Tonit të Atlantikut. Lidhur me inspektimin dhe kontrollin, gjobitja për peshkimin e paligjshëm u rrit substancialisht. Megjithatë, mbledhja e shumave është e varfër por konfiskimi i pajisjeve dhe mbyllja e licencave po përdoren si siguruës. Forcimi i Ligjit dhe implementimi kërkon kujdes të mëtëjshëm. Drejtoria e Politikave të Peshkimit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave nuk ka anije inspektimi. Ajo duhet të mbeshtetet në Policinë e kufijve, e cila nuk ka trajnimin e duhur për inspektimin e peshkimit. Shqipëria po bën progres drejt krijimit të një dokumenti udhëtimi në përputhje me BE dhe një fletë regjistrimi peshkimi. Megjithatë, një sistem i të dhënave ende është në fazën e përgatitjes së hershme. Përgatitjet në fushën e peshkimit po përparojnë në mënyrë të moderuar.

4.2.3 Mjedis

Progres mund të raportohet në fushën e **Legjislacionit Horizontal**. Pjesa e dytë e Metodologjisë Kombëtare për Vlerësimin e Impaktit të Mjedisit (EIA) u aprovua. Një strategji sektoriale për mjedisin gjithashtu u aprovua. Ligji Kombëtar për Mjedisin u ndryshua dhe qeveria aprovoi një Vendim për përfshirjen e publikut në vendimet e mjedisit. Megjithatë, implementimi i legjislacionit të EIA ka nevojë të përmirësohet. Lidhur me ndryshimin e klimës, disa përpjekje mund të shihen, në vecanti lidhur me zhvillimin e Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (CDM). Disa aktivitete janë zbatuar në fushën e mbrojtjes civile.

Progres i kufizuar mund të raportohet në **cilesine e ajrit** në zonat urbane. Pajisje te reja monitorimi u siguruan dhe kontratat u firmosen për monitorimin e cilesisë së ajrit. Ndotjet nga makinat dhe nga industritë e mëdha janë ulur lehtësisht. Megjithatë, nuk ka një politikë afat gjatë të përcaktuar qartë se si të zvogelohet (t'i japet fund) ndotjes së ajrit dhe të reduktohen nxjerrjet nga këto dy burime. Forcimi i legjislacionit ekzistues për nxjerrjet e makinave dhe cilesisë së lëndëve djegëse është i pakët. Shqipëria është vetëm në një faze të hershme të periudhës së monitorimit të cilesisë së ajrit.

Shqipëria ka bërë pak progres në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Qeveria miratoi disa rregulla implementimi. Përveç rehabilitimit të groposjes së Sharres nuk ka pasur zhvillime lidhur me menaxhimin e mbetjeve të bashkive. Zbrazja dhe djegia e shpërdoruar dhe e pakontrolluar ende përfaqëson rrezik mjedisi dhe shëndeti.

Po vazhdon puna për rehabilitimin e pikave të nxehta toksike, në veçanti për Uzinën e Shkrirjes së Bakrit në Rubik, Uzinën e Plehrave të Nitratit në Fier, Uzinën Kimike në Durrës si edhe rafinerinë e naftës në Ballsh. Ka filluar tashmë projekti për identifikimin dhe vlerësimin e pikave të nxehta mjedisore. Sidoqoftë, Shqipërisë i mungon një sistem modern i mbledhjes, asgjësimit dhe riciklimit të mbetjeve, si edhe nuk është hartuar një strategji e qartë për asgjësimin e sigurtë të mbetjeve të rrezikshme. Përgatitjet në fushën e administrimit të mbetjeve nuk kanë bërë progres.

Ka pasur njëfarë progresi në fushën e cilësisë së ujit. Numri i stacioneve që monitorojnë ujin e pijshëm është rritur në mënyrë të konsiderueshme si edhe është përmirësuar në njëfarë mase niveli i aksesit ndaj sistemit të furnizimit me ujë (ujësjellësve). Sidoqoftë, ujërat sipërfaqësore janë dëmtuar në masë të madhe nga ndotja urbane dhe ajo industriale. Sistemet e furnizimit me ujë (ujësjellësat) dhe ato të kanalizimeve mbeten të vjetëruara. Ekziston vetëm një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ndotura) në vend, por që ende nuk është vënë në punë. Katër të tjerë janë në fazat përfundimtare të ndërtimit. Ndotja e ujërave për larje mbetet një problem serioz në disa vende për shkak të shkarkimeve të drejtpërdrejta nga sistemet e kanalizimeve apo nga industria. Ende nuk është miratuar Strategjia Kombëtare e Sistemit të Ujësjellës-Kanalizimeve. Përgatitjet në këtë fushë kanë njohur një progres mesatar.

Është bërë njëfarë progresi në fushën e mbrojtjes së natyrës. Direktiva për Habitatet është transpozuar më tej si edhe është miratuar ligji për Zbatimin e Konventës CITES. Zonat e mbrojtura tani përfshijnë 11.4% të territorit kombëtar. Sidoqoftë, duhen siguruar trajnime të mëtejshme dhe burime të mjaftueshme për stafin që operon në këto zona. Ekziston nevoja e vazhdimin të përafrimit të direktivave për Shpendët e Egër dhe Habitatet. Duhet të bëhen ende përpjekje nga ana e Shqipërisë për të përmbushur angazhimet e marra prej saj në lidhje me mjedisin në kuadrin e Traktatit të Komunitetit për Energjinë. Përgatitjet në këtë fushë kanë njohur një progres mesatar.

Progres i bërë mund të raportohet edhe në drejtim të ndotjes industriale dhe administrimit e rrezikut. Ligji për mbrojtjen e mjedisit është amenduar për të siguruar transpozimin e disa prej dispozitave në lidhje me këto fusha.

Nuk mund të raportohet asnjë zhvillim në lidhje me kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Është bërë miratimi i legjislacionit për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis si edhe për nivelet maksimale të zhurmave në mjedise të caktuara. Përgatitjet në këtë fushë janë ende në një fazë të hershme.

Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për fuqizimin e kapacitetit administrativ të të gjitha institucioneve të përfshira në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndër-institucional ende ka nevojë që të përmirësohet. Ende nuk është miratuar Strategjia Kombëtare Mjedisore. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme në drejtim të ratifikimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare.

Përafrimi i përgjithshëm i legjislacionit me *acquis* po bën një progres të ngadaltë, por implementimi dhe zbatimi i tij ende ka mbetur prapa. Përgatitjet në fushën e mjedisit kanë njohur një progres të ngadaltë.

4.2.4. Politika e transporteve

Në fushën e rrjeteve trans-evropiane të transporteve ka pasur progres. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë aktivisht në zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin 2004 për zhvillimin e Rrjetit Qendror Rajonal të Transporteve, si edhe në Observatorin e Transporteve të Evropës Jug-lindore (SEETO) duke përditësuar dhe zbatuar planin shumëvjeçar 2008-2012. Ka vazhduar puna në lidhje me projektet e Korridorit të VIII-të si edhe në rrugët e aksit veri-jug. Rruga Durrës-Kukës –Morinë mbetet një nga prioritetet e Shqipërisë.

Qeveria ka ngritur Institutin e Transporteve si një njësi shërbimi për Minsitrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve. Instituti do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e Planit Kombëtar për Transportet në Shqipëri (ANTP) si edhe për krijimin dhe ruajtjen e një Baze të Dhënash qendrore për transportet , për të gjitha llojet e transporteve në Shqipëri. Strategjia Kombëtare për Transportet u miratua në gusht të vitit 2008.

Është bërë progres edhe në fushën e transportit rrugor. Pranimi në operatorin e transportit rrugor të pasagjerëve dhe mallrave si edhe njohja e dokumentave të kërkuara për ushtrimin e veprimtarisë rregullohen nga legjislacioni i ri. Shqipëria po garanton akses të pakufizuar përmes territorit të saj për në trafikun e tranzitit të Komunitetit në përputhje me Marrëveshjen e Ndërmjetme. Sidoqoftë, kërkohet ende një thjeshtëzim i mëtejshëm i trafikut të transportit rrugor të mallrave, si për trafikun ndërkombëtar ashtu edhe për atë tranzit.

Po bëhet riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve(DPR) në një agjensi e cila merret me kontraktimin e firmave private për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Skuadra e Zbatimit të Reformës u krijua në maj të vitit 2008, ndërsa Njësia e Administrimit u krijua në korrik të vitit 2008. Puna për rishikimin e legjislacionit kombëtar është në progres, si edhe në lidhje me kërkesat financiare dhe operacionale. DPR ka filluar punën për krijimin e Sistemit të Administrimit të Aseteve Rrugore si edhe ka prezantuar kontratat e mirëmbajtjes në bazë të performancës në një numri të Drejtorive Rajonale të Rrugëve. Është rritur buxheti për sinjalistikën rrugore. Sidoqoftë, ende duhen bërë përpjekje të qëndrueshme me qëllim përmirësimin e cilësisë së mirëmbajtjes së rrugëve. Gjendja e keqe e rrugëve, së bashku me sinjalistikën e mangët, ndërtimet e paligjshme përgjatë rrugëve të reja si edhe edukimi(arsimimi)

në një nivel të kufizuar i drejtuesve të automjeteve , vazhdojnë të paraqesin një problem serioz për sigurinë në rrugë. Përgatitjet në fushën e transportit rrugor kanë njohur një progres të ngadaltë.

Progresi ka qenë mjaft i kufizuar në sektorin e transportit hekurudhor. Në dhjetor të viti 2007, Shqipëria nënshkroi “ Shtojcën e Memorandimit të Mirëkuptimit për Zhvillimin e Rrjetit Qendror Rajonal të Transporteve të Evropës Jug-lindore për Zonën e Transportit Hekurudhor të Evropës Jug-lindore, duke synuar hapjen graduale të tregut për tregun e transportit hekurudhor.. Që nga janari i vitit 2008, hyri në fuqi riorganizimi i hekurudhave shqiptare. Synimi i këtij riorganizimi është ndarja e degëve të pasagjerëve, mallrave, infrastrukturës dhe shërbimeve në njësi individuale biznesi. Sidoqoftë, plan i biznesit për hekurudhat në Shqipëri ende nuk është miratuar. Puna për përgatitjet në sektorin e transportit hekurudhor ka mbetur prapa.

Progresi në fushën e transportit detar ka qenë i kufizuar. Parlamenti miratoi legjislacionin përkatës për aderimin e Shqipërisë në Koventën Ndërkombëtare për kontrollin dhe administrimin e ujërave balaste të anijeve . Legjislacioni që ka për synim anëtarësimin në Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit për kontrollin Shtetëror të Porteve është miratuar gjithashtu.

Përditësimi i Master Planit për portin e Durrësit përfundoi në korrik. Ka filluar puna për krijimin e Administratës së re Detare. Sidoqoftë, duhen bërë ende përpjekje të konsiderueshme me qëllim përmirësimin e sigurisë detare. Norma e lartë që ka Shqipëria për ndalimin e anijeve të cilat konsiderohen si jashtë standartit , në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit, mbetet kritike. Lista e zezë e qershorit 2008 e hartuar nga Memorandumi i Mirëkuptimit i Parisit, ende e cilëson flamurin shqiptar si një rrezik shumë të madh dhe performancën e Regjistri Shqiptar të transportit me anije si të ulët. Përgatitjet në fushën e transportit detar janë ende në një fazë të hershme.

Përsa i përket transporteve të kombinuara, nuk mund të raportohet asnjë lloj progresi.

Ka pasur progres të mëtjshëm në fushën e transportit ujor. Drafti i Kodit të ri Ajror ka përfunduar. Ende nuk është konfirmuar përputhja e tij me acqui-në, në pajtim me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes për Aviacionin e Përbashkët Evropian (ECAA). Po vazhdon puna për zbatimin e fazës së parë transitore të ECAA-së. Sidoqoftë, ka pasur vonesa në zbatimin e planit korrektues të veprimit të miratuar në gusht të vitit 2007 në trajtimin e mangësive të evidentuara brenda Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë (CAA) në drejtim të sigurisë së linjave ajrore të vendit. Ende duhen bërë përpjekje për fuqizimin e kapacitetit administrativ të CAA-së, meqë struktura e tij e re organizative nuk është përfunduar. Përgatitjet në fushën e transportit kanë njohur një progres mesatar.

4.2.5. Energjia

Është bërë progres në drejtim të rezervave të naftës. Qeveria amendoi Vendimin “Për mirëmbajtjen dhe administrimin e rezervave të emergjencave të naftës”. Këto rezerva tani bazohen në konsumin mesatar të 60 ditëve në vend të 30 ditëve. Sidoqoftë, duhen krijuar mekanizmat e përshtatshëm për monitorimin e duhur të tyre.

Kanë vazhduar veprimtaritë për përmirësimin e sigurimit të furnizimit me energji. Vazhdon ndërtimi i termocentralit të Vlorës. Shqipëria ka nënshkruar 25 marrëveshje koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, si edhe po merren në shqyrtim 87 propozime të tjera. Po bëhen përgatitjet e duhura për nënshkrimin e një marrëveshjeje koncesionare për rehabilitimin e termocentralit në Fier. Ka filluar puna edhe në linjën e interkonjeksionit (ndërlidhjes) Elbasan-Podgoricë si edhe në qendrën Kombëtare të Shpërndarjes. Sidoqoftë, Shqipëria vazhdon të mos jetë në gjendje të ofrojë siguri në drejtim të furnizimit me energji elektrike. Vendi varet kryekëput nga prodhimi i hidrocentraleve, dhe burimet e tij prodhuese nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e brendshme. Kapaciteti i kufizuar i interkonjeksionit vazhdon të pengojë kapacitetin e Shqipërisë për të importuar elektricitet.

Është shënuar progres në fushën e tregut të brendshëm të energjisë. Në qershor të vitit 2008 u miratua ligji për sektorin e gazit. Qeveria ka miratuar modelin e tregut të energjisë elektrike ndërsa Autoriteti Rregullator i Energjisë (ERE) rishikoi dhe miratoi rregullat e tregut, me qëllim sigurimin e kuadrit të nevojshëm për hapjen dhe funksionimin e tregut të shitjes me shumicë dhe atij të pakicës. Duke filluar nga janari i vitit 2008 të gjithë konsumatorët jo-familjarë u bënë konsumatorë potencialë dhe iu dha e drejta që të zgjedhin furnizuesit e tyre në përputhje me kërkesat e Traktatit të Komunitetit për Energjinë. Sidoqoftë, të gjithë klientët me përjashtim të njërit kanë zgjedhur të qëndrojnë si klientë me tarifa në vitin 2008. U krijua një strukturë monitoruese brenda ERE-s për të lejuar zbatimin e përgjegjësive të tij për monitorimin e tregut. Pjesa më e madhe e procedurave të reja të rishikimit janë bërë efektive. Sidoqoftë, ERE duhet të rrisë kapacitetet e tij vendimarrëse si edhe të sigurojë transparencën e procesit të vendimmarrjes. Vazhdon procesi i ristrukturimit të KESH-it. Operatori i Sistemit të Transmetimit u shpërbë dhe ka hartuar pasqyrat e tij financiare. U miratua legjislacioni për krijimin e Operatorit të Sitemit të Shpërndarjes si një ent i pavarur dhe procesi i privatizimit të tij është në rrugë e sipër.

Tarifat e energjisë elektrike u rritën mesatarisht me 15% në mars si një përpjekje për t'i afruar ato më shumë me nivelet e rikuperimit të kostove. Humbjet teknike u reduktuan dhe u rrit niveli i shlyerjes së faturave. Sidoqoftë, përpjekje të mëtejshme janë ende të nevojshme në këtë fushë. Importe të mëdha të energjisë vazhduan të dëmtojnë situatën financiare të KESH-it. Ende nuk është miratuar Strategjia e rishikuar Kombëtare e Energjisë.

Nuk ka pasur progres në zbatimin e ligjit për efikasitetin energjetic të vitit 2005. Është vënë re njëfarë progresi në sektorin hidroenergjetik, por zhvillimi dhe shfrytëzimi i burimeve të tjera të energjisë së rinovueshme mbetet në një fazë fillestare.

Është vënë re një progres i kufizuar në fushën e sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Kuadri rregullator përfshin Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimi dhe Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi përkatësisht si organizma rregullues dhe ekzekutivë. Qeveria ka miratuar legjislacionin për importin e instrumentave radiologjikë dhe burimeve radioaktive.

Sidoqoftë, pavarësia dhe kapacitetet e organizmave rregullatorë kanë nevojë të fuqizohen. Duhet vazhduar përpjekjet për të siguruar përmbushjen e kërkesave dhe procedurave të Traktatit të Euratomit, në veçanti në drejtim të monitorimit mjedisor dhe mbrojtjes nga rrezatimi në kontekstin e zbatimeve mjekësore dhe industriale. Shqipëria nuk e ka firmosur ende Konventën për Sigurinë Bërthamore si edhe Konventën e Përbashkët për Sigurinë e Administrimit të Karburanteve (Lëndëve Djegëse) të shpenzuara dhe atë për Sigurinë e

Administrimit të Mbetjeve Radioaktive. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të trafikimit të paligjshëm të substancave bërthamore dhe materialeve të tjera radioaktive.

Në përgjithësi, përpjekjet po avancojnë në drejtim të reformës të tregut të brendshëm të energjisë. Sidoqoftë, dobësitë e konstatuara në sektorin e energjisë elektrike vazhdojnë të pengojnë rritjen e ekonomike dhe zhvillimin shoqëror të vendit. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për ristrukturimin e KESH-it dhe për stabilizimin e situatës së saj financiare, si edhe për sigurimin e furnizimit me energji, të cilat janë prioritetet kryesore të partneritetit evropian.

4.2.6. *Shoqëria e informacionit dhe media*

Është bërë progres në fushën e komunikimit elektronik dhe teknologjive të informacionit. Legjislacioni i ri parësor për komunikimin elektronik, që synon transpozimin e kuadrit rregullator 2002/2003 të BE-së, hyri në fuqi në qershor të vitit 2008. Në dhjetor të vitit 2007 u miratua rregullorja për aksesin dhe ndërlidhjen dhe operatori ekzistues i linjës tokësore amendoi marrëveshjet e interkonjeksionit me operatorët ruralë. Në bazë të ligjit të ri, u miratua një metodologji e re e tarifave e cila trajton tarifën e tre operatorëve më të mëdhenj (fiksë dhe celularë) si në nivelin e shitjes më shumicë ashtu edhe atë të pakicës. Ai filloi të zbatohet më 1 shtator 2008, duke çuar në reduktimin e përgjithshëm të tarifave. Një operator i tretë i telefonisë celulare filloi nga puna në mars të vitit 2008 dhe enti rregullator i telekomunikacioneve shpalli një tender publik për shprehjen e interesit për një operator të katërt.

Sidoqoftë, ende nuk është miratuar një strategji për komunikimin elektronik apo dokumentat e politikave përkatëse, si edhe nuk është bërë miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për komunikimin elektronik. Liberalizimi i tregut dhe konkurrenca janë ende në një fazë fillestare. Në përgjithësi, mungojnë instrumentat e mbrojtjes së konkurrencës të tillë si ribalancimi i tarifave, oferta të mira për referencat e interkonjeksionit, përzgjedhja dhe parapërzgjedhja e transportuesve, mbartshmëria e numrave dhe shpërbërja e rrjeteve lokale. Amendamenti legjislativ i vitit 2006 që u lejoi operatorëve të aplikojnë për licensa rurale dhe kombëtare, nuk pati ndikimin e pritshëm në vitin 2007.

Kapaciteti administrativ i Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve si edhe ai i Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare AKEP (ish- Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ERT) nuk është i mjaftueshëm. Agjencia duhet të zhvillojë ekspertizën e nevojshme për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e komunikimit elektronik kanë pasur një progres mesatar.

Është bërë progres edhe në drejtim të shërbimeve të shoqërisë së informacionit. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), filloi punën në shtator të vitit 2007. Objektivi i saj kryesor është bashkërendimi i të gjitha veprimtarive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve, dha aktualisht stafi i saj përbëhet nga 20 punonjës. Ligji për nënshkrimin elektronik u miratua në shkurt të vitit 2008. Sidoqoftë, legjislacioni për zbatimin e ligjit për nënshkrimin elektronik, dhe për mbrojtjen e të dhënave, ashtu si edhe legjislacioni për tregëtinë elektronike dhe dokumentat elektronikë, nuk është përfunduar ende. Strategjia kombëtare për shoqërinë e informacionit është ende në përgatitje e sipër dhe nuk ka pasur progres në drejtim të legjislacionit për aksesin e kushtëzuar. Përgatitjet në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit janë ende në një fazë fillestare.

Është shënuar progres në drejtim të politikës audio-vizuale. Strategjia për kalimin në transmetim dixhital është hartuar në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë dhe me aktorët përkatës. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) ka miratuar rregulloret për licensimin e transmetimit dixhital si edhe për kriteret e dhënies së licensave për transmetimin tokësor dhe televizion analog në nivel kombëtar. Aktet Përfundimtare të Konferencës Rajonale të Radio Komunikimit për planifikimin e shërbimit të transmetimit dixhital tokësor në pjesët e rajoneve 1 dhe 3 në brezat (bandat) e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) u ratifikuan, ashtu si edhe Aktet Përfundimtare të Konferencës Rajonale të Radio Komunikimit për rishikimin e Marrëveshjes së Stokholmit të vitit 1961.

KKRT-ja e ka rritur kapacitetin e tij si edhe ka shtuar numrin e punonjësve. Ai e shndërroi Këshillin e tij të Ankesave në një Këshill Etike. Këshilli i Etikës ka luajtur një rol pozitiv në vetë-rregullimin, inkurajimin për hartimin e një kodi etike nga çdo operator radioje dhe televizioni, me synimin e unifikimit të ketyre kodeve në një të vetëm. Sidoqoftë, kapaciteti monitorues i KKRT-së kufizohet nga burimet e tij teknike të pamjaftueshme. Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e politikës audio-vizuale kanë bërë progres, por puna për Planin e Veprimit në drejtim të reformës në media, për të cilin është rënë dakord me Këshillin e Evropës, duhet të përshpejtohet. (shikoni gjithashtu edhe seksionin politik).

4.2.2. Kontrolli financiar

Është bërë një progres modest në fushën e Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar. U miratua projekt-ligji i ri Organik për Buxhetin nga parlamenti në qershor të vitit 2008. Ai paraqet dispozitat kuadër për Kontrollin e Brendshëm Publik Financiar dhe komponentët e tij-respektivisht administrimin dhe kontrollin financiar (AKF), auditin e brendshëm dhe funksionin e harmonizimit qendror. Ai përfshin gjithashtu edhe një ndërmarrje për të nxjerrë një ligj të veçantë për AKF-në si edhe një Ligj për Inspektimin në periudhën e ardhshme. Prandaj, Ligji për Auditin e Brendshëm që u miratua në vitin 2007 duhet të amendohet, me qëllim që të jetë në pajtim me të gjithë kuadrin ligjor për Kontrollin e Brendshëm Publik Financiar. Njësia e Harmonizimit Qendror për AKF-në u krijua në korrik të vitit 2008 si një Drejtori brenda Thesarit. Janë emëruar gjithashtu drejtori i saj dhe tre anëtarë të stafit.

Dokumenti i Politikës i Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar i vitit 2005 dhe Plan i tij i Veprimit ende nuk janë përditësuar. Përgjegjshmëria administrative dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve të Administrimit dhe Kontrollit Financiar janë ende në fazë embrionike. Njësitë e decentralizuara të auditit të brendshëm janë ngritur në të gjitha ministritë si edhe në disa agjensi qeveritare, por ato vazhdojnë të kryejnë kryesisht detyrat e inspektimit dhe kontrollit dhe linjat e tyre të raportimit nuk janë të qarta. Njohuritë e administratorëve të Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar vazhdojnë të jenë të kufizuara.

Përsa i përket auditit të jashtëm, pavarësia operationale e Kontrollit të Lartë të Shtetit është rritur, me Komisionin e Buxhetit të Parlamentit që ka vetëm të drejtën e miratimit të buxhetit të tij. Sidoqoftë, ligji për KLSH-në, ende nuk është plotësisht në pajtim me standartet e INTOSAI-t dhe ka nevojë për ndryshime, veçanërisht në drejtim të kriterëve për shkarkimin e Kryetarit si edhe reduktimin dhe fushën e zbatimit të auditit. Është shënuar një progres i kufizuar në largimin nga veprimtaritë e inspektimit në drejtim të auditeve financiare dhe të mbështetura tek

sistemet. Strategjia e Zhvillimit për periudhën 2009-2013 ende duhet të hartohet me qëllim fuqizimin e institucionit si edhe të performancës së auditit.

Në përgjithësi, përpjekjet në fushën e kontrollit financiar po ecin me hapa të ngadaltë.

4.2.8. Statistikat

Është vënë re progres në fushën e infrastrukturës së statistikave. Buxheti për zyrën shqiptare të statistikave (INSTAT) është rritur, nivelet e pagave janë rritur dhe është marrë në punë staf shtesë. Kushtet e punës në mjediset e INSTAT-it janë përmirësuar. Zyrat janë rinovuar dhe infrastruktura IT është përmirësuar. Është hartuar një strukturë e re organizative e INSTAT-it e cila përcakton reduktimin e numrit të zyrave rajonale nëpërmjet shkrirjes së zyrave në nivel prefekturë. Programi statistikor shumëvjeçar 2007-2011 u miratua nga Parlamenti. Banka e Shqipërisë dhe INSTAT-i nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për të siguruar përmirësimin e statistikave monetare dhe financiare. Sidoqoftë, duhen nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me prodhues të tjerë statistikash.

Është bërë progress në klasifikimet dhe regjistrat. Shumica e klasifikimeve kryesore statistikore janë bërë efektive dhe janë në përputhje me standartet e BE-së. Sidoqoftë, ende nuk është bërë klasifikimi i rajoneve statistikore i krahasueshëm me klasifikimin e nivelit 2 NUTS. Cilësia e regjistratit statistikor të biznesit ka ende nevojë për përmirësime.

Progres i dukshëm është bërë në disa statistika kryesore sektoriale. Përsa i përket statistikave demografike dhe sociale, rezultatet e studimit për buxhetin familjar dhe studimi për fuqinë punëtore i viti 2007 janë të disponueshme. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë është planifikuar për vitin 2011 dhe INSTAT-i ka filluar të bëjë veprimtaritë përgatitore. Sidoqoftë, ende duhen marrë masa për të siguruar regjistrimin gjithëpërfshirës të të gjitha ngjarjeve demografike.

Duhen bërë përpjekje për përmirësimin e statistikave në nivelin rajonal për të plotësuar kërkesat e reja që lindin nga procesi në vazhdim i decentralizimit. Në fushën e statistikave rajonale, të dhënat janë mbledhur kryesisht nga burime administrative dhe vetëm në nivel qarku. Për sa i përket statistikave makroekonomike, llogaritë kombëtare trimestrale janë përgatitur duke filluar që nga vitit 2005, por duhet bërë punë e mëtejshme për t'i bërë llogaritë kombëtare të pajtueshme me ato të ESA 95.

Mbulimi i statistikave të biznesit është përmirësuar që nga fillimi i vitit 2008. Përsa i përket statistikave bujqësore, ka filluar përgatitja e një regjistrimi të përgjithshëm për bujqësinë. Sidoqoftë, duhen bërë përpjekje për të siguruar që statistikave të bujqësisë përmbushin standartet e BE-së, si edhe lind nevoja e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Bujqësisë.

Në përgjithësi, është vënë re progres në fushën e statistikave. Përgatitjet po avancojnë, por ende janë të nevojshme përmirësime të mëtejshme në fushat kryesore, të tilla si statistikave makroekonomike, rajonale, të biznesit dhe ato bujqësore.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1. Vizat, kontrolli i kufijve, azili dhe migracioni

Është shënuar progres në administrimin e vizave. Përgatitjet për një regjistër civil të besueshëm dhe një sistem uniformë adresash po bëjnë përparime. Kompjuterizimi i të dhënave të regjistrimit civil ka përfunduar. Në shtator, zyrat e gjendjes civile filluan printimin e çertifikatave. Në korrik të vitit 2008, një shoqëri fitoi kontratën për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike. Përfundimi i regjistrimit civil dhe i sistemit të adresave është shumë i rëndësishëm si burim të dhënash për kartat e identitetit si edhe për të garantuar sigurinë e duhur të dokumentave.

Marrëveshja për lehtësimin e vizave mes KE-së dhe Shqipërisë hyri në fuqi në janar të vitit 2008. Filloi dialogu për liberalizimin e vizave ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë dhe në qershor të vitit 2008 u bë prezantimi i planit ku specifikoheshin masat që duhen ndërmarrë. Shqipëria e paraqiti raportin e saj të parë për zbatimin e planit në fjalë në shtator të vitit 2008.

Shqipëria ka një regjim pa viza për të gjitha Vendet Anëtare të BE-së. Ajo nënshkroi marrëveshjen për heqjen e vizave me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në shkurt të vitit 2008. Aktualisht, listat pozitive dhe negative nuk janë plotësisht të harmonizuara me listën e vizave të BE-së, por përgatitjet janë në rrugë e sipër.

Ligji për të Huajt, i miratuar në korrik të vitit 2008, përfshin rregullat e amenduara për lëshimin e vizave në kufi. Për lejet e qëndrimit mbi tre muaj, do të kërkohet gjithashtu edhe një vizë, kur të hyjë në fuqi ligji në dhjetor të vitit 2008. Për momentin, vizat e lëshuara në kufi kufizohen ose për arsye humanitare ose tek vizat turistike kryesisht për vendet e Amerikës Latine të cilat janë në listën pozitive të BE-së. Janë ndërmarrë hapat fillestarë për krijimin e qendrës kombëtare të vizave. Në përgjithësi, Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres mesatar në drejtim të administrimit të vizave.

Shqipëria ka bërë progres në fushën e **kontrollit të kufijve**. Ligji i ri për Kontrollin e Kufirit Shtetëror u miratua në janar të vitit 2008. Policia Shqiptare e Shtetit ka hartuar raportin e progresit në lidhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Administrimin e Integruar të Kufijve si edhe Planin e Veprimit që lidhet me të. Zbatimi i objektivave të Strategjisë Kombëtare për Administrimin e Integruar të Kufijve për vitin 2008 është në rrugë e sipër, dhe po avancohet me ritme mesatare, veçanërisht në drejtim të aspekteve të IT-së së pikave të kalimit kufitar dhe infrastrukturës. Sidoqoftë, pavarësisht nga përmirësimet, duhen bërë investime të mëtejshme për përmirësimin e infrastrukturës së pikave të kalimit kufitar. 15 nga 26 pika të kalimit kufitar janë lidhur në mënyrë elektronike nëpërmjet Sistemit të Administrimit të Informacionit Total dhe janë furnizuar me pajisjet përkatëse. Janë organizuar disa takime ndërkufitare mes policisë kufitare të Shqipërisë dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Oficerët e policisë kufitare lokale bashkëpunojnë mjaft mirë me homologët e tyre përtej kufirit. Nivelet e pajisjes me staf në forcën e policisë kufitare mbeten të ulëta. Marrëveshjet ekzistuese dypalëshe për bashkëpunimin policor sigurojnë një bazë të sigurtë ligjore për bashkëpunimin ndërkufitar. Sidoqoftë, bashkëpunimi ndërkufitar ka nevojë për më tepër përmirësim dhe institucionalizim. Kanë filluar bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje funksionale me FRONTEX-in.

Ndërtimi i pikës së kalimit kufitar me Malin e Zi në Murriqan nisi në maj të vitit 2008. Ndërtimi i pikës së kalimit kufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka filluar në Xhepsht Trebisht.

466 rojeve të kufirit të rangut të mesëm dhe atij të lartë u është siguruar trajnim i specializuar. Duhet të zbatohet ende një politikë trajnimi më e gjerë dhe më afatgjatë, e cila synon ndërtimin e kapacitetit për diktimin e dokumentave të falsifikuara, të migrantëve të paligjshëm apo viktimave të trafikimit.

Ligji për Rojen Bregdetare, i miratuar në vitin 2007, përfshin ndarjen e detyrave ndërmjet policisë kufitare dhe rojes bregdetare dhe është duke u zbatuar, edhe pse me ritme të ngadalta. Komanda civile e rojes bregdetare, në pajtim me angazhimet e Ohrit, është ende e pazgjidhur. Ende nuk është krijuar qendra e përbashkët e operacioneve për bashkërendimin e operacioneve detare. Kapaciteti administrativ dhe operacional i rojes bregdetare mbetet i pamjaftueshëm. Pajisjet për patrullimin e kufijve detarë duhet të përmirësohen. Nevoitet trainim special dhe kordinim me l afert midis policise kufitare dhe autoriteteve të doganes.

Mbi të gjitha, Shqipëria vazhdon pjesërisht të ndjeke objektivat e saj në fushën e kontrollit kufitar. Por burimet njerezore janë të pamjeftueshme për të realizuar këto detyra me efikasitet.

Ka një progres të kufizuar për të raportuar mbi çështjet e azilit. Nje sistem efikas i azilit ende nuk është vendosur. Rishikimi i kuadrit ligjor për përafrimin me Standartet e Komunitetit Evropian nuk është përfunduar. Që në janar të 2008, tetë persona kanë kërkuar strehim në Shqipëri. Njëri prej tyre ka kërkuar azil të përkohshëm në fushën humanitare.

Burimet njerëzore dhe financiare në Departamentin për shtetësinë dhe refugjatët nuk janë të mjaftueshëm për të permbushur obligimet e Konventes së 1951 lidhur me statusin e regugjatit, vecanerisht për implementimin e sistemit të kontrollit paraprak. Kordinimi me forcat e policisë është i dobët. Procedurat për azil në qendrat e pritjes nuk janë të aplikuara në mënyrë standarde. Infrastruktura ka nevojë për t'u përmirësuar.

Nevojitet një sistem menaxhimi të dhënash më efikas për azilin dhe emigracionin, nevojiten më shumë të dhëna për të përcaktuar një regjistër emigracioni dhe nje hartim i emigranteve shqiptare jashtë kufinjve. Sistemi TIMS i përfshirë në 15 pika kufitare nevojitet të shndërrohet në një mjet efikas për menaxhimin dhe mbledhjen e të dhënave.

Përgjithësisht, Shqipëria vazhdon të plotësojë pjesërisht objektivat e saj në fushën e azilit.

Progres i pjesshëm mund të raportohet në fushën e emigracionit. Në maj 2008, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale miratoi një Plan kordinimi dhe Monitorimi për implementimin e nje Strategjie Nderkombëtare mbi emigracionin, duke përfshirë dhe Planin e veprimit shoqëruar. Ministria po kordinon aktivisht implementimin e strategjisë, por mekanizmat e kordinimit ndërministror ende nuk janë krijuar. Përgatitjet për implementimin e strategjisë së migrimit janë duke përparuar, edhe pse me hapa të ngadaltë.

Kulmi sezonal i migracionit ilegal qëndron problematik, sidomos në kufinjte midis Shqipërisë dhe Greqisë, në sajë të nevojave të medha për punësim sezonale në bujqësi.

Ky kufi është pika më problematike hyrëse për emigracionin ilegal për në BE nga Shqipëria. Në tetë muajt e parë të 2008, një total personash prej 9382 janë kapur në kufi dhe rreth 5955 persona në total në vitin 2007. Megjithëse asnjë rast i emigrimit ilegal përtej kufinjve blu nuk është kapur, ende është e nevojshme të shtohet kontrolli i kufinjve duke siguruar një infrastrukturë adekuate.

Zbulimi i emigracionit ilegal është përmirësuar në sajë të shtimit të aftësive zbuluese të policisë kufitare. Rezultatet e gjysmës së parë të vitit 2008 tregojnë shkallë më të lartë refuzimi për hyrje në Shqipëri. Zbulimi falsifikimit të pasaportave të huaja në pjesën e parë të vitit 2008 gjithashtu barazohet me rezultatet totale të raportuara në 2007.

Departamenti për Policine Kufitare dhe Emigracionin është duke përmirësuar pritjen dhe lehtësimin e procedurave për emigrantët ilegale në disa nga kufinj të kryesorë të kalimit. Gjithsesi, pajisjet në pergjithësi janë të pakta. Kordinimi me vendet fqinje mbi emigracionin ilegal ka nevojë për përmirësim.

Në janar të 2008, drejtori të reja rajonale u ngritën brenda policisë kufitare dhe të migracionit. Policia kufitare konsiston në tetë drejtori rajonale dhe 34 stacione policie kufitare, 12 prej të cilave shërbejnë si pika të pritjes së të rikthyerve. Një njësi Kthimi dhe ripranimi u caktua brenda Departamentit të Policisë Kufitare dhe emigracionit. Gjithsesi, shpërndarja e burimeve njerëzore mbetet e pamjaftueshme, sidomos në sezonet kulmuese të hyrje-daljeve.

Shqipëria nënshkroi protokolle duke implementuar marrëveshjen e nënshkruar për ripranimin ndërmjet BE dhe Shqipërisë kryesisht nga vendet e Austrisë dhe Benelux dhe hartoi protokolle me Greqinë dhe Republikën Çeke. Negociatat po vazhdojnë për të rinovuar protokollin për ripranimin me Italinë dhe për të nënshkruar protokolle me Francën, Slloveninë dhe Sllovakinë. Shkurtime stafi policor kufitar dhe emigracioni mund të kushtëzojnë kapacitetin e Shqipërisë për të plotësuar detyrimet ndaj marrëveshjes së ripranimit.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me Kroacinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Dispozitat e marrëveshjes së ripranimit Shqipëri-BE në lidhje me ripranimin e shtetasve të vendeve të treta hynë në fuqi në Maj të 2008. Pjesa tjetër e marrëveshjes ka hyrë në fuqi në 1 Maj 2006. Një qendër e mbyllur pritje është duke u ndërtuar, por akomodimi i shtetasve të vendeve të treta qëndron inadkuat.

Në përgjithësi, emigracioni ilegal qëndron një problem i rëndësishëm, sidomos në kufirin e gjelbër midis Shqipërisë dhe Greqisë. Shqipëria vazhdon të jetë pjesërisht e vonuar në plotësimin e objektivave të saj në fushën e migracionit.

4.3.2 Pastrimi i parave

Progres i kufizuar është bërë në luftën kundër pastrimit të parave, i cili vazhdon të jetë një problem i madh. Ekonomia e Shqipërisë, sidomos sektori privat, qëndrojnë të bazuara në përgjithësi në transaksionet me para në dorë. Në kushtet e mekanizmit për të kontrolluar transaksionet në cash, nuk funksionon asnjë strategji.

Ligji mbi Pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit u miratua në Maj të 2008, por aktet nënligjore për implementimin e tij janë në pritje. Në 2008, disa rregullore u miratuan për trajtimin e asetëve të konfiskuara. Kurse trajnimi u organizuan për bankat dhe noterët. U zvogëluan kufinjët për raportimin e transaksioneve dhe tani janë në linjë me standartet ndërkombetare. Megjithëse ligji përfshin instrumente ndërkombetare, sic është rekomandimet e MoneyVal, ende nuk është në linjë plotësisht me *acquis*. Nevojitet një përkufizim më i mirë i koncepteve dhe udhëzimeve për implementim.

Ende nuk është adoptuar një strategji kombëtare për të parandaluar dhe luftuar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Një Drejtori e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, (Njesia financiare e Inteligjences FIU), nën Ministrinë e Financave, është përgjegjëse për mbledhjen, analizën dhe përhapjen e inteligjences financiare. Janë përmirësuar zyrat dhe niveli i pajisjeve. Gjithsesi, kapaciteti i FIU qëndron i kufizuar. Qarkullimi i stafit mbetet problem. Kordinimi dhe bashkëpunimi me Zyrtarët e Prokurorisë qëndron problematik.

Një zyrë e re për luftën kundër pastrimit të parave, së bashku me policinë e shtetit, operuan deri në Janar të 2008. Gjithsesi, lidhja midis inteligjences kriminale dhe hetimeve mbetet e dobët. Mungesa e kordinimit midis gjykatës dhe policisë gjithashtu rezulton në inteligjence të paproceduar, e cila në vijueshmeri humbet. Kapaciteti hetues dhe përforcues i policisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm mbetet i dobët.

Është ngritur një grup pune (Task Force) pranë Prokurorit të Përgjithshëm. Njësia e përbashkët e Hetimeve për Luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit (JIU) është në vazhdim. Gjithsesi, kapaciteti administrativ i JIU kërkon forcim të mëtejshëm.

Progres mund të raportohet lidhur me shkëmbimin e monedhave të përgjithshme. Banka e Shqipërisë ka aprovuar rregulla të reja mbi licencimin dhe mbikqyrjen e zyrave të shkëmbimit valutor. Numri i zyrave të shkëmbimit të licencuara zyrtarisht është rritur. Kontrollat në pikat kufitare të kalimit gjithashtu janë shtrënguar.

Në përgjithësi, përgatitjet në luftën kundër pastrimit të parave janë në një fazë të sapofilluar.

4.3.3 Drogat

Progresi në luftën kundër drogës ka qenë i kufizuar, por trafiku i drogës mbetet një problem kyç.

Një strategji ndërkombëtare kundër Drogës për periudhën 2004-2010 është në fuqi, por implementimi vështirësohet nga kufizimi i stafit dhe akordimi i burimeve financiare. Kapaciteti administrativ për të implementuar strategjinë ka nevojë për zhvillime të mëtejshme.

Progresi i pjesshëm mund të raportohet në formën e nënshkrimeve, në Nëntor 2007, të Urdhërave të përbashkëta për ndalimin e përdorimit të drogës në shkolla dhe universitete dhe mbajtjen e narkotikëve. Urdhëri i Ministrisë së Brendshme kundër kultivimit të narkotikeve hyri në fuqi në fillim të vitit 2008. Autoritetet filluan disa hetime mbi 2000 çështje droge në 2007. Deri më sot, nuk ka pasur asnjë strategji koherente apo të vlefshme për reduktimin e kërkesës

për droge dhe gadishmëria e shërbimeve që sigurohen - përfshire trajtimet dhe parandalimet - mbeten të kufizuara.

Hetimet mbi ceshtjet e lidhura me drogen janë rritur. Shuma të mëdha kokaine dhe kanabis janë konfiskuar. Në kontrast me këtë, sasirat e heroinës që trafikohen në pikat e kalimit kufitar kanë rënë rreth 50 %.

Qeveria vazhdon të përdorë task forcat e përbashkëta kundër narkotikeve , e cila përfshin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, policisë kufitare, policisë tatimore, policisë rrugore dhe autoriteteve doganore. Bashkëpunimi i agjencive të brendshme është përmirësuar dhe bashkëpunimi nderkombëtar në fushën e luftës kundër narkotikëve vazhdon. Një theks i veçantë duhet të vihet në trajnimin e personelit të luftës kundër narkotikëve.

Në 2008, u ndërtua një depozitë qendror për drogën e kapur dhe një qendër për zhdukjen e drogave. Gjithashtu, procedura për ruajtjen, analizimin dhe shkatërrimin e drogës së kapur ka nevojë për transparencë.

Në anën e prodhimit, një plan aktiv për kultivimin e bimëve narkotike u aprovua në Mars të vitit 2008. Për periudhën e raportimit, kultivimi i kanabis është reduktuar dukshëm. Gjithashtu Shqipëria mbetet një vend furnizues për kanabisin. Nuk ekziston asnjë program zëvendësues prodhimi.

Në përgjithësi , Shqipëria po bën një progress të moderuar në luftën kundër drogës.

4.3.4 Policia

Ka pasur një progres të vazhdueshëm në menaxhimin e **policisë së shtetit**, me hyrjen në fuqi në 2008 të Ligjit të ri të Policisë Shtetërore. Fusha të tjera në të cilat është arritur progres përfshijnë kufinjte dhe sigurimin në port, reforma trajnimi dhe krijimi i sistemit informativ të kontrollit të kufinjve si databazat dhe sistemet e kontrollit të pasaportave dhe gishterinjve. Gjithsesi, linjat e paqarta të përgjegjësive dhe llogaridhënia e paketë midis trupave përkatës qëndrojnë çështje për tu shqyrtuar.

Ligji për policinë e shtetit Shqiptar ka treguar efektin e tij pozitiv kryesisht tek policët drejtues gjithashtu dhe në rekrutimin e strukturave sipas kategorive të oficerëve. Edhe pse kontrolli i strukturave të brendshme është në zhvillim e sipër niveli i stafit të policisë shqiptare akoma nuk është i stabilizuar. Transferimi i policeve oficerë në bazë kualifikimi dhe eksperience përfunduar në qershor 2008, nxori në pah mangësi të dukshme vecanerisht në departamentet e specializura, përse me siper praktika e lëvizjes së stafit të kualifikuar dhe trainuar më parë nga postet perkatese është duke dhene ndikimin e tij policinë shqiptare. Një problem tjetër është ai i mbajtjes në polici për deri tre vjet i stafit që ka dështuar në testet bazë të kompetencës. Manaxhimi në përgjithësi i sektorit të burimeve njerëzore në këtë institucion le vend për të dëshiruar.

Në Prill të 2008, u firmos një marrëveshje bashkëpunimi midis policisë së shtetit dhe Prokurorisë për përcaktimin e përgjegjësive dhe reduktimit të përplasjeve gjatë investigimit. Megjithë

skemën pilot të formave të raportimit të standardizuar, ka pasur pak progress në lidhje me krijimin e ketyre standarteve te menyese se raportimit.

Akoma kapaciteti investigues i të dyjave paleve, prokurorise dhe policise se shtetit ka mbetur i dobet. Ai karakterizohet nga mungesa e bashkepunimit dhe shfaqja paralele e strukturave investiguese brenda perbrenda Prokurorise.

Perpjekje të mëtejshme duhen për zhvillimin dhe vendosjen e strukturave të besueshme statistikore mbi krimin pasi shume krime të ndodhura nuk raportohen dhe të dhenat e pakta mbi keto krime jane të pashpjegueshme.

Shqiperia ka filluar të implementojë marrëveshjen strategjike me Europol e cila ka hyrë në fuqi në Maj 2007, gjë e cila dëshmon për një bashkëpunim më të ngushte dhe nje shkembim informacioni më të sukseshëm. Europol dhe Shqiperia jane duke konkluduar një marrëveshje operacionale për ndryshimin dhe shkëmbimin e të dhenave personale. Tashme Shqipëria ka ratifikuar konventen e Bashkepunimit të policise se europes jug-lindore e cila ka hyre në fuqi në 2007. Implementimi i strategjise se së policisë komunitare ka filluar.

Përsa i përket përgatitjeve në lidhje me menyrën e qeversjes së këtyre strukturave ato vazhdojnë të përparojnë por përmirësimet strukurore kanë nevojë të ndiqen nga rezultate operacionale.

4.3.5. Lufta kunder krimin të organizuar dhe terrorizmit

Progres i kufizuar mund të raportohet për krimin e organizuar, i cili është një nga prioritetet e partneritetit european. Strategjia kombëtare për luftën kundër krimin të organizuar miratuar në korrik të 2008 mbetet akoma për tu implementuar. Krimi i organizuar vazhdon të jetë një problem serioz për Shqiperinë.

Veshtirësitë në bashkepunimin ndërmejt policisë dhe prokurorëve vazhdojne të demtojnë luftën kunder krimin të organizuar. Edhe pse bashkëpunimi midis organizmave është përmirësuar në nivelet e larta, në nivel operativ mbetet problematik. Standardizimi i raportimit duhet të jetë kyç i progresit këtu.

Aktualisht vihet re një mungesë kapacitetesh për tu perballur me operacione afatgjata për krimin e organizuar. Ky problem agravohet për arsye të mungeses se kapaciteteve njerëzore për menaxhimin e këtyre operacioneve. Nuk ekzistojnë manuale për të drejtuar prokurorët për investigime. Që nga maji 2008 shumë oficerë policie që punojnë brenda qarqeve juridike të zyrave të prokurorisë jane kthyer për të punuar në Policine e shtetit. Kjo duhet të ndihmoje në permiresimin e bashkëpunimit dhe uljes së mbivendosjeve. Sidoqoftë, kapaciteti investigues brenda policisë së shtetit dhe zyrës së prokurorit të përgjithshëm mbetet i dobet.

Bashkëpunimi ndërmjet Interpol Tirana dhe shteteve të tjera ka vazhduar vecanerisht në kufijte me Greqine. Numri i shqiptarëve të kerkuar të kapur dhe kthyer është rritur. Vetëm në gjashtemujorin e pare të 2008, janë bërë 62 ekstradime në Shqipëri. Si rezultat i një bashkëpunimi ndërkombetar disa organizata kriminale që operojnë jashtë janë shkatërruar dhe janë arrestuar udhëheqësit e tyre.

Plani kombetar i veprimit kunder trafikimit dhe makinave të vjedhura u miratua në Prill të 2008. Implementimi vazhdon. Sidoqoftë, bashkepunimi ndërmjet organeve të ndryshme të zbatimit të ligjit mbetet ceshtje.

Sa i përket përdorimit të të dhënave të inteligjencës kriminale, nëpunësit e informacionit të MEMEX, rezultojnë të jenë akoma në Ministrinë e Brendshme dhe jo në drejtorinë e policisë. Përmirësime në mënyrën se si policia e shtetit mbledh dhe përdor inteligjencën janë kritike në mënyrë që të perfitohet plotësisht nga teknologjia MEMEX.

Progres është shënuar në **luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore** megjthate mbetet akoma shumë punë për të bërë vecanërisht në fushën e mbrojtjes së viktimave dhe identifikimit të tyre. Shqipëria vazhdon të jetë shteti burim i trafikimit të qënieve njerëzore vecanërisht të grave dhe vajzave për shfrytëzim prostitucioni. Trafikimi i fëmijëve për qëllime lypje apo shfrytëzimi për punë është gjithashtu problematik. Afërsisht gjysma e viktimave të trafikuar në Shqipëri janë nën moshën 18 vjec.

Trafikimi i brendshëm i grave dhe fëmijëve është në rritje, vecanërisht në komunitetin e Romëve.

Kodi penal i amenduar në Shkurt të 2008 parashikon pikërisht fuqizimin e aspektit ligjor në lidhje me penalizimin e trafikimit të qënieve njerëzore. Baza e të dhënave mbi viktimat e trafikimit është instaluar në departamentin e policisë kufitare dhe migrimit por akoma nuk është ende operacional.

Zyra kombetare e anti-trafikimit koordinoi procesin e konsultimit që çoi në miratimin e strategjisë kombëtare në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, në korrik të 2008 dhe një plan veprimi për periudhën 2008-2010. Strategjia për mbrojtjen e fëmijëve viktimat të trafikimit u miratua gjithashtu por përsëri mbetet për tu bërë përsa i përket mbrojtjes së viktimave.

Një dëshirë politike më e mirë dhe bashkëpunim do të duheshin për implementimin e kësaj strategjie anti-trafikim, vecanërisht në mbrojtjen kundër viktimave.

Zyra e koordinimit kombëtar anti-trafik (ONAC) ka mbajtur takime me shtetet fqinje për të nxitur bashkëpunimin rajonal ku dhe është bërë e mundur firmosja e një protokollit me ish republikën e Maqedonisë në 2008, e cila përfshinte referimin dhe kthimin e asistuar të viktimave. Marreveshje janë firmosur gjithashtu dhe me Malin e zi dhe Maqedoninë e Kosovën, për shkëmbim informacioni në lidhje me aktivitetin kriminal në kufi.

Sidoqoftë, mungesa e statistikave të besueshme dhe kapaciteti i duhur për të identifikuar viktimat po pengon progresin. Bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve dhe organeve që merren me zbatimin e ligjeve ka nevojë për përmirësim. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet strukturave të ngritura rishtazi në nivel rajonal dhe lokal (autoriteti përgjegjës dhe komitetet rajonale anti-trafikim) është akoma i dobët. Mekanizmat e referimit kombëtar nuk janë vënë ende në funksion: nuk ka gjithëpërfshirje të procesit apo mbrojtje alternative të viktimave të trafikimit. Trainimi i zyrtarëve të sektorit anti-trafik duhet vazhduar.

Shqipëria pjesërisht ka përmbushur objektivin e saj në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Sa i përket luftës ndaj terrorizmit Shqipëria ka vazhduar të bëjë përpara. Keshilli i konventës Europiane për parandalimin e terrorizmit u ratifikua në vitin 2005. Strategjitë dhe planet e veprimit në lidhje me këtë çështje janë në përgatitje e sipër. Strategjia kombëtare e Luftës kundër terrorizmit është duke u përgatitur përfshirë policinë, inteligjencën, shërbimet e sigurimit bashkë me një numër aktorësh të tjerë.

Në përgjithësi, në luftën kundër krimit të organizuar, Shqipëria po vazhdon progres mesatar. Shqipëria po përmbush vetëm pjesërisht objektivat kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Përgatitjet për një kuadër më eficient kundër-terrorizëm janë ende në fazat e para.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Është vënë re progres në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Një ligj mbi ruajtjen e të dhënave personale hyri në fuqi në Prill 2008. Në shtator 2008 Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave u caktua nga parlamenti dhe struktura për autoritetin e mbrojtjes se pavarur të të dhënave u ra dakord. Në përgjithësi, përgatitjet në këtë fushë janë duke përparuar.